

SËMUNDJET GJENITALE

IBRAHIM TREBINJAC



SËMUNDJET GJENITALE

Mubammed Ali El-Barr

PROSTITUCIONI

Ibrahim Trebinjac

Titulli origjinal:

EL-EMRAD EL-XHINSIJE

Autor:

Dr. Muhammed Ali el-Barr

Titulli origjinal:

BLUD (ZINA, PROSTITUCIJA)

Autor:

hfz. Ibrahim Trebinjac

Nga boshnjakishtja përktheu:

Nig'jar Bajrami Hoti

Kryeredaktor:

Ammar Hoti

Redaktor profesional në aspektin mjekësor:

Teuta Shala Abrashi

Lektor & Korrektör:

Arlind Boshnjaku

© Copyright – nigjar.hoti@gmail.com

www.nigjarehoti.com

الأمراض الجنسية

مجموعة مؤلفين

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të All-llahut, të
Gjithmëshirshmit, Mëshiruesit

Parathënie

I falënderohemi All-llahut, i Cili na mësoi të shkruajmë. I Cili na e mësoi atë që nuk e dimë. Falënderimi i qoftë All-llahut, i Cili ata që besojnë i nxori nga errësira në dritë dhe i përudhi në rrugë të drejtë :

“Dhe kjo është rruga Ime e drejtë, pra përmbahujuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij.” [El-En`am: 153]

All-llahu i Lartësuar gjithashtu thotë: ***“Thuaj: ‘A thua janë të njëjtë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?’*** [Ez-Zummer: 9]

I Lartësuari po ashtu thotë:

“Atëherë pra, pranojeni All-llahun, të Dërguarin e Tij dhe Dritën që e zbritëm Ne.” [Et-Tegabun: 8]

Bekimi i All-llahut qoftë mbi mësuesin, mbi të Dërguarin tonë të fesë, Muhammedin ﷺ, i cili udhëzon në udhëzimin më të mirë:

“Thuaj: ‘Mua me të vërtetë më është e qartë kush është Zoti im.’ [El-En`am: 57]

Dituria më e lartë është njohja e All-llahut, e ajo na drejton në njohjen e mënyrës së zbatimit të fesë së Tij. Sa më tepër të zgjerohet dituria fetare, aq më pak do të ketë turbullira dhe

padituria do të pakësohet. Në hadithe përmendet: *“Vlera e alimit (djetarit) në krabasim me abid-in (besimtarin) është si vlera e bënës së plotë në krabasim me yjet e tjerë.”* Sepse ibadeti më i çmuar, më i lartësuar dhe i cili më së shumti meriton për t’u pranuar është ai ibadet i cili është në përputhshmëri dhe në pajtim me Sheriatin e nderuar. Ndërsa qëllimi dhe arsyeja e ekzistimit është bërja ibadet All-llahut:

“Unë nuk i krijova xhinnët dhe njerëzit për tjetër, pos që të Më adhurojnë.” [Edh-Dharijat: 56]

Sëmundjet Gjenitale

Burimet mjekësore trajtojnë sëmundjet gjenitale, ngase ato janë tani ndër sëmundjet më të përhapura ngjitëse në botë. S'ka dyshim se sëmundjet gjenitale janë sëmundjet ngjitëse më të përhapura në Perëndim, pas mposhtjes së suksesshme të shumicës së sëmundjeve të tjera ngjitëse. Sëmundjet gjenitale janë shfaqur si sëmundje shumë të rrezikshme ngjitëse.

Në doracakun e njohur mjekësor Merk Manual (botimi i 13, 1977) qëndron:

“Sëmundjet gjenitale janë sot sëmundjet më të përhapura në botë. Që dy dekada për çdo vit shtohet numri i të sëmurëve. Organizata Ndërkombëtare për Shëndetësi (WHO) ka vlerësuar se për çdo vit nga gonorreja (triperi) sëmuren 250 milionë persona. Gjithashtu WHO vlerëson se për çdo vit sëmuren 50 milionë nga sifilizi (syphilis). Atlanta, qendra për luftë kundër sëmundjeve ngjitëse, në krahinën e Xheorxhisë në SHBA, vlerëson se në SHBA për çdo vit nga gonorreja sëmuren tre milionë persona dhe 400 000 nga sifilizi (syphilis).

Po kështu vlerësohet se numri i të sëmurëve nga sëmundjet e shkaktuara me klamidian (chlamydia) dhe me mikrobe të tjera që shkaktojnë inflamacion të kanaleve urinare dhe të kanaleve gjenitale (përkrah gonorresë) është dyfish më i lartë në SHBA, në vendet Evropiane dhe në të gjitha vendet e botës ku janë bërë hulumtime të këtij lloji.

Sëmundje të shumta dhe të ndryshme janë përhapur për shkak të shtimit të prostitucionit dhe të seksit të shthurur, veçanërisht në Perëndim.

Revista mjekësore (Medicine digest, prill, 1977) transmeton një raport nga Florida (SHBA), të paraqitur nga një ekip specialistësh për sëmundjet femërore, ku thuhet: “Shtimi i gjendjeve që janë

identike me kancerin e qafës së mitrës te vajzat, mosha e të cilave sillet ndërmjet viteve 15 dhe 22, e kalon përqindjen prej 800%, në periudhën ndërmjet viteve 1970 dhe 1974. Hulumtuesit konsiderojnë se ky shtim i tmerrshëm është shkaktuar me shtimin e pakontrolluar të marrëdhënieve seksuale.

Që të mund të bënim një krahasim, të shikojmë se çka thotë profesori Villiëm Bejkers, i cili në vendet arabe qëndroi me shërbim më tepër se njëzet vjet:

“Organet më të pastra gjenitale janë ato që i kam kontrolluar në Arabinë Saudite...” Ai kishte kryer kontroll të hollësishëm të më shumë se 30 000 grave në Arabinë Saudite dhe kishte marrë mostra nga vagina dhe nga qafa e mitrës. Të gjitha ato mostra kanë treguar se janë të pastra nga gonokoku (gonorrhoea), nga klamidia (chlamydia), nga trikomonasi (trichomonas), nga kërpudhat parazitare dhe nga kanceri i qafës së mitrës. Profesori Villiëm Bejkers thotë se shkak i një gjendjeje të tillë janë dy gjëra: zinaja e rrallë dhe synetimi i meshkujve. (Këtë gjithashtu e ka botuar gazeta “Medicine Digest”, prill 1977)

Shkaqet e përhapjes së Sëmundjeve Gjenitale

I Dërguari 齾 ka thënë: *“Kur në një popull shfaqet zinaja dhe përhapet aq shumë, saqë të bëhet sheshazi, në të do të lajmërohet murtaja dhe sëmundjet të cilat nuk ekzistojnë në mesin e të parëve të tyre, të cilët jetuan para tyre.”*

(Transmeton: Hakimi, Ibën Maxhe dhe El-Bazzar)

Dr. Shofild, në librin e tij “Sëmundjet gjenitale” (botimi i tretë), ndër të tjera thotë: “Me të vërtetë mjetet e informimit (mas-mediumet) thërrasin në anarkizëm (në liri të pakufizuar në çdo gjë, e edhe në seks), të cilën e konsiderojnë si gjendje të natyrshme biologjike... Ekziston një bindje e gabueshme te njerëzit, se antibiotikët mund të shërojnë çdo sëmundje gjenitale që lajmërohet si rezultat i sjelljeve të këtilla!

Dr. Teodor Kuper, kryetar i shoqatës për kulturë shëndetësore dhe zëvendës-ministër i shëndetësisë në SHBA, thotë: “Moral i njeriut është pengues, kur janë në pyetje sëmundjet gjenitale dhe përhapja e tyre.”

Dr. Andrew Rigg, profesor i mjekësisë për fëmijë (pediatër), në universitetin Xhorxh Uashington në SHBA, thotë: “Tre shkaktarët kryesorë në përhapjen e sëmundjeve gjenitale janë: amoraliteti (prostitucioni), mjetet kontraceptive (kondomët) dhe bindja e gabuar se antibiotikët mund t'i shërojnë këto sëmundje”.

Elizabetha Manners në librin e vet “The Vulnerable Generation” (“Gjenerata e atakuar”) thotë: “Me të vërtetë vajzat në shkollë u janë ekspozuar keqpërdorimeve të ndyra, valës shkatërruese të materializmit, në të cilën i shtyejnë mas-mediumet dhe grupet e tregtarëve të seksit, që në këtë mënyrë realizojnë përfitime të mëdha materiale.

Dr. Hit në librin e tij “Fatamorgana e lirisë”¹ thotë: “Zgjidhja e problemit të përhapjes së sëmundjeve gjenitale qëndron në luftën kundër përhapjes së amoralitetit dhe në propagandimin e pastërtisë, të nderit dhe të përparësive të jetës së pastër familjare.”

I Dërguari ﷺ ka thënë: ***“Kur në një popull shfaqet zinaja (prostitucioni) dhe përhapet deri në atë masë, sa që ajo bëhet sheshazi, në të do të shfaqet murtaja dhe sëmundje që nuk ekzistonin në mesin e të parëve të tyre, që para tyre jetuan.”*** (Trans. Hakimi, Ibën-Maxhe dhe El-Bezzar)

“Kur në një vendbanim të caktuar lajmërohet zinaja dhe kamata, atëherë banorët e tij e meritojnë dënimin e All-llabut ﷻ.” (Trans. El-Hakimi nga Ibën-Abbasi dhe thotë që hadithi është sahih).

Të vërtetën e ka thënë i Dërguari ﷺ. Të gjitha ato që i ka thënë seriozisht ose në shaka janë të vërteta, e ky hadith paraqet një nga mu’xhizet e tij (vepra mbinatyrore).

Çdo herë kur në një popull të caktuar përhapet zinaja (prostitucioni), në të lajmërohen murtaja dhe sëmundje (nocioni murtajë përdoret për të gjitha sëmundjet ngjitëse) që nuk njiheshin nga të parët e tyre, të cilët jetuan para tyre. Kështu p.sh. sifilizi nuk ishte i njohur para luftës italo-franceze. Atëherë kur në mesin e ushtarëve u lajmërua dhe u përhap zinaja, si pasojë e kësaj pas përfundimit të luftës në vitin 1494 u shfaq për herë të parë sifilizi. Francezët e quanin sëmundje italiane, kurse italianët e quanin sëmundje franceze. Mëpastaj nga kjo sëmundje u sëmur edhe vetë Napoleoni dhe kardinali Rishelje, i cili ishte një nga kardinalët dhe nga priftërinjtë më të njohur evropianë.

Kur evropianët në fund të shek. IX dhe në fillim të shek XX hynë në tokat arabe, përmes fushatave të tmerrshme kolonialiste, me vete bartën edhe këtë sëmundje të keqe, të cilën bota e rëndomtë islame e njihnte si “sëmundje e të huajve”.

Sida (sindroma e imuno-mungesës së fituar) po ashtu më herët ka qenë e panjohur. Rastet e para të sida-s janë shënuar në Belgjikë, në

¹ Fatamorganë-a – *fig.* Halucinacion, vegulli, mashtrim.

mesin e disa punëtorëve dhe të nëpunësve që kishin qenë në Zaire (Zairianë ose Evropianë që kishin qenë me punë në Zaire). Në vitin 1979 sida lajmërohet edhe në SHBA. Në vitin 1980 janë shënuar vetëm 58 raste të sida-s, kurse në vitin 1981 231 raste. Në vitin 1982 janë shënuar 883 raste të sëmurëve nga sida, kurse në vitin 1983 paraqiten 3064 raste të sida-s vetëm në SHBA. Jashtë SHBA-ve atë vit janë shënuar përafërsisht 2000 raste. Është konstatuar se 72% e këtyre rasteve kanë qenë persona që merreshin me “seks të shfrenuar”, të cilët në Angli janë të njohur si Harolds, e në Amerikë nën emrin Gays (të shturur).

Në vendet perëndimore janë përhapur sëmundje gjenitale që më parë kanë qenë shumë të rralla, sikurse që janë: herpesi, lythar dhe zgjebja e organeve gjenitale, morrat e vendeve gjenitale, klamidia, mikoplazma dhe sëmundje të tjera gjenitale.

Hulumtuesit perëndimorë konsiderojnë se ekzistojnë disa shkaktarë kryesorë të përhapjes së sëmundjeve gjenitale. Dr. Villkoks në gazetën mjekësore për Amerikën Veriore (Medical Clinics J. N. America 1972. 5. 60) thotë:

“Nga shkaktarët e zgjerimit dhe të përhapjes së sëmundjeve në mjediset perëndimore, përkundër përparimit të mrekullueshëm të mjeksisë, janë edhe këto:

1. Qëndrimi tolerues dhe lejimi i marrëdhënieve (të lira) seksuale në shoqëri, para dhe pas martesë (d.m.th. miratimi i zinasë dhe i homoseksualizmit, si dhe trajtimi i kësaj dukurie nga shoqëria si gjë normale).

2. Rritja e numrit të udhëtarëve dhe të të ardhurve, për shkak të punës a turizmit. Numri i punëtorëve që kanë lëshuar vendet e tyre për shkak të punës kalon shifrën prej 6 milionë, kurse numri i turistëve në vitin 1975 ka qenë 215 milionë.

3. Përdorimi i shtuar i mjeteve për parandalimin e shtatzënësisë, duke qenë se shtatzënësia ishte një nga arsytet më të forta që ndalonte gruan nga marrëdhëniet seksuale. Humbja e këtij faktori ndikoi që të shtohet zinaja tek gratë, pa iu frikësuar shtatzënësisë.

4. Përhapja e “seksit të lirë” të një gruaje me shumë meshkuj dhe e kundërta. Meshkujt më nuk kënaqen vetëm me një grua, as gruaje

me vetëm një mashkull, por njeriu kryen marrëdhënie seksuale me numër të madh grash dhe e kundërta. Po ashtu, edhe seksi i shfrenuar po përhapet shumë shpejt nëpër vendet perëndimore.

5. Shfaqja e llojeve të caktuara mikrobesh kundër të cilave nuk ndihmojnë antibiotikët, sikurse që është hibrizi, si dhe shfaqja e sëmundjeve të shkaktuara nga viruset kundër të cilave nuk vlejné antibiotikët.

Dr. Kenxhi në librin e tij “Sëmundjet veneriane” (botimi i katërt 1980) thotë:

“Me të vërtetë shpresat tona që i kishim në mjetet e mjekësisë bashkëkohore për pengimin dhe për çrrënjosjen e sëmundjeve veneriane tani ka herë kanë rënë në ujë. Kjo nuk është çudi kur janë në pyetje sëmundjet ngjitëse shumë të rrezikshme, të cilat shumë shpejt përhapen me kontakte seksuale. Shkaku i përhapjes së tyre fshihet në rrethanat shoqërore dhe në ndryshimet e mënyrës së sjelljes njerëzore. Në shoqëritë perëndimore me të shpejtë u përhap “liria e seksit,” veçanërisht në mesin e të rinjve, prej të cilëve shumica e kanë humbur ndjenjën e vetëkontrollit, të dashurisë dhe të ngrohtësisë së jetës familjare.”

“Në perëndim janë bërë përpjekje të mëdha në fushën e ngritjes së vetëdijës shëndetësore për rrezikun nga sëmundjet veneriane, por përkundër të gjithave, është vërejtur se këto kanë qenë të pasuksesshme, ngase shkollat dhe insitucionet mjekësore vënë theks në mjetet për pengimin e shtatzënisë dhe në largimin nga sëmundjet, e jo në shmangien e marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore”. “Me fjalë të tjera: shmangia nga zinaja, nga homoseksualizmi, nga safizmi (homoseksualiteti midis grave) dhe nga punët e tjera amorale.”

Dr. Shofild në librin e tij “Sëmundjet gjenitale” (botimi i tretë) argumenton përhapjen e shpejtë të sëmundjeve veneriane dhe konsideron se shkak i kësaj është shfaqja dhe përhapja e “seksit të lirë” (promiskuiteti) dhe numri i madh i partnerëve seksualë. Ai konsideron se përhapja e “seksit të lirë” ka ndodhur nga shkaqet vijuese:

1. Rritja e botëkuptimeve materialiste dhe largimi nga feja dhe nga

morali fetar;

2. Rritja e prodhimit të mjeteve për parandalimin e shtatzënisë;

3. Shtimi i numrit të udhëtarëve dhe të të ardhurve, për punë a për turizëm;

4. Qëndrimi tolerant i shoqërisë ndaj zinasë (prostitucionit), ndaj homoseksualizmit, ndaj dukurive të shfrenuara të marrëdhënieve seksuale;

5. Përhapja e informacioneve dhe të të dhënave mbi seksin, nëpërmjet mjeteve të informimit;

6. Përdorimi i drogës dhe i alkoolit;

7. Pjekuria e hershme e djemve dhe e vajzave, kështu që tani koha e moshës madhore është 11/12 vjet, në vend të 14/16 vjet, sikur që ishte më parë;

8. Punësimi i nënave jashtë shtëpisë, çka solli deri te mungesa e lidhjes emocionale ndërmjet fëmijëve dhe prindërve, edhe përkrah statusit të lartë social.

Dr. Shofild, më tutje, thotë:

“Qëndrimi tolerant i shoqërisë ndaj të gjitha formave të marrëdhënieve seksuale është në rritje të vazhdueshme, saqë më nuk ekziston asnjë ndjenjë turpi nga prostitucioni, nga homoseksualizmi a nga cilido lloj tjetër i seksit të ndaluar a jonormal. Përkundrazi, mjetet për informim kanë formuar bindje të tillë sipas së cilës është turp për djalin ose për vajzën të jenë të virgjër. Pastërtia e djemve dhe e vajzave në Perëndim është bërë një gjë plotësisht e pakuptimtë. Mas-mediumet bëjnë presion të posaçëm mbi djemtë dhe vajzat, siç veprojnë edhe moshatarët e tyre ndaj shokëve dhe shoqeve të tyre, derisa në fund detyrohen t’u bashkëngjiten në këtë.

Mjetet e informimit thërrasin në “seks të lirë” dhe e inkurajojnë atë duke e konsideruar si dukuri normale dhe të natyrshme. Ekziston edhe një kënaqësi iluzore e shkaktuar nga bindja se antibiotikët janë në gjendje të shërojnë cilëndo sëmundje veneriane që lajmërohet për këtë shkak.

Mjetet për kontracepcion:

78% e grave të pyetura për aventurat e tyre jashtëmartesore janë

përgjigjur se mjetet për parandalimin e shtatzënësisë kanë qenë motiv plotësues për këtë.

Shumë prej tyre janë shprehur në mënyrë falënderuese ndaj mjeteve të kontracepcionit, të cilat u kanë mundësuar grave të barazohen me meshkujt në çështjet e lirisë seksuale, sepse shtatzënësia më nuk është shkak i kufizimit të lirisë së saj seksuale. Pandaj shumica e grave në Perëndim janë bërë mbrojtëse të “seksit të lirë” dhe këtë e praktikojnë që nga vitet e hershme të tyre.

Rezultat i kësaj është rritja e madhe e triperit dhe e sëmundjeve të tjera veneriane tek të rinjtë në pubertet, në krahasim me kohët e mëparshme.

Në artikullin e Dr. Jamesa Noxa Russel-it, të botuar në gazetën “Journal of Hospital Medicine” 29/2, në vitin 1983, ku bëhet fjalë për shtatzënësinë e vajzave në shkolla, qëndron:

“Përkundër rritjes së procesit të edukimit për përdorimin e mjeteve për parandalimin e shtatzënësisë në Angli dhe në Uells, në periudhën 1974-1978 janë shënuar 18851 raste të shtatzënësisë së vajzave, moshë e të cilave nuk i kalon 15 vjet. 12873 vajza kanë abortuar, kurse të tjerat kanë qenë këmbëngulëse në përfundimin e periudhës së shtatzënësisë. Të dhënat statistikore tregojnë se shtatzënësia te vajzat e moshave të reja shkollore (deri 16 vjet) është në rritje të vazhdueshme. Në SHBA një në çdo pesë raste të shtatzënësisë është te vajzat më të reja se 18 vjet.

Elizabetha Manners në librin e vet “The Vulnerable Generation” (“Gjenerata e atakuar”) thotë: “Me të vërtetë vajzat në shkolla u janë ekspozuar keqpërdorimeve të ndyra, valës shkatërruese të materializmit, në të cilën i shtyjnë mas-mediumet dhe grupet e tregtarëve të seksit, të cilët në këtë mënyrë realizojnë përfitime të mëdha materiale.

Në librin “The Illusory Freedom” - “Fatamorgana e lirisë,” të shkruar nga Hit në vitin 1978, qëndron:

“Zgjidhja e problemit të përhapjes së sëmundjeve gjenitale qëndron në luftën kundër përhapjes së amoralitetit dhe në propagandimin e pastërtisë, të nderit dhe të përparësisë së jetës së pastër familjare.”

Në doracakun mjekësor Merk (botimi i 13, në vitin 1977) qëndron:

“Përkundër përparimit të mrekullueshëm të mjekësisë në fushën e diagnostikës dhe të shërimit, e cila ka arritur të çrrënjosë shumë sëmundje ngjitëse në botë, sëmundjet veneriane në mënyrë të hatashme janë përhapur në 25 vitet e fundit. Sipas mendimit tonë, ekzistojnë disa arsye për këtë kontradiktë:

Ndryshimet e mëdha të edukimit seksual në 25 vitet e fundit, gjatë së cilës kohë u shfaq i ashtuquajtur “revolucion i seksit”, përhapja e tabletave, e spiraleve dhe e mjeteve të tjera për pengimin e shtatzënësisë. Mes shkaktarëve të tjerë janë lajmëruar edhe mikrobe të reja që janë rezistente ndaj antibiotikëve. Mandej, numër i madh grash që vuajnë nga sëmundjet veneriane fare nuk i vërejnë simptomat e këtyre sëmundjeve, sidomos në vetë fillimin e tyre. Pastaj lehtësia e udhëtimit në vende të ndryshme të botës, veçanërisht në Perëndim, shtimi i marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore dhe dëfrimet seksuale grupore nga shumë persona në të njëjtën kohë.

Prej arsyeve të rëndësishme është edhe përhapja e seksit anormal, që është i përcjellur me sëmundje të rrezikshme. Mandej, anonimiteti, fshehja dhe mosinformimi i botës për rrezikun e këtyre sëmundjeve dhe për përhapjen e tyre.”

Në librin “Sëmundjet veneriane në vendet e nxehta” qëndrojnë shkaqet vijuese:

1. Përhapja e prostitucionit në shumë pjesë të Azisë dhe të Afrikës, ku prostitucioni konsiderohet shkaktar kryesor i përhapjes së sëmundjeve virusale në vendet në zhvillim, në Azi, në Afrikë dhe në Amerikën Latine, në dallim prej vendeve të zhvilluara të Perëndimit, ku prostitucioni nuk luan rol të madh. Për shkak se vendet e Perëndimit në përgjithësi janë të goditura me “seksin e lirë” dhe roli i prostitutave është zvogëluar në mënyrë të ndjeshme. Vajzat që këtë e bëjnë nga hobi janë bërë konkurrenca të prostitutave dhe i kanë tejkaluar në këtë! Në vendet e pazhvilluara prostitutat edhe më tutje lozin rolin më të madh në përhapjen e sëmundjeve virusale;

2. Varfëria, e cila shumë vajza i shtyen në prostitucion;

3. Profesione të rrezikshme, siç janë: marinarët, forcat e

armatosura, punëtorët dhe nëpunësit hotelierë, vendet për argëtim, baret dhe klubet e natës, aero-kompanitë, veçanërisht stjuardesat, punëtorët e arteve të bukura, teatrot, sallat për vallëzim dhe muzikantët;

4. Turizmi;

5. Udhëtimi i punëtorëve dhe largimi i tyre nga familjet;

6. Mjetet për pengimin e shtatzënisë;

7. Shtimi i arsimimit të përzier (me djem dhe vajza së bashku);

8. Shpërngulja nga fshatrat në qytet, dhe vala e industrializimit;

9. Shpenzimet e mëdha martesore;

10. Mjetet e ndryshme të informimit që e theksojnë seksin;

11. Seksi anormal. Ky është problem i theksuar në Perëndim, i cili ende nuk është studiuar në vendet në zhvillim;

12. Ekzistimi i bazës konstante dhe pjellore për mikrobe tek prostitutat dhe tek ata që praktikojnë seks anormal;

13. Zhvillimi i mikrobeve që janë rezistente në antibiotikë. Sot më shumë se dy të tretat e mikrobeve që shkaktojnë triperin janë rezistene ndaj penicilinës;

14. Përhapja e alkoolit dhe e drogës;

15. Mosparalajmërimi i pushtetit dhe i institucioneve shëndetësore për rrezikun dhe seriozitetin e këtij problemi, çka sjell deri te rritja e tij, pa kurrfarë rezistimi serioz;

16. Bindja e rrejtshme se penicilina dhe antibiotikët mund të shërojnë cilëndo sëmundje veneriane.

Dr. Andrau Rigg, profesor i mjekësisë për fëmijë në universitetin Xhorxh Uashington, në SHBA, thotë:

“Tri gjëra kryesore në përhapjen e sëmundjeve gjenitale janë: amoraliteti (prostitucioni), mjetet kontraceptive (kondomët) dhe bindja e gabuar se antibiotikët mund t'i shërojnë këto sëmundje”.

Revista Proctitioner Vol 214/Shkurt 1975.

Dr. Teodor Kuper, zëvendës ministër i shëndetësisë në SHBA dhe kryetar i shoqatës së kulturës shëndetësore, në mbledhjen mbi sëmundjet veneriane në Londër (22-25 qershor 1975) ka thënë: “Moral i njeriut është pengimtar kur janë në pyetje sëmundjet gjenitale dhe përhapja e tyre...”

Prandaj sëmundjet veneriane quhen sëmundje shoqërore, ngase ato janë rezultat i sjelljes së caktuar, që nuk i përmbahet marrëdhënieve të ligjshme seksuale brendamartësore, por praktikohen marrëdhënie jashtëmartësore, para dhe pas martese.

Nga studimet e cekura dhe të tjera vijmë në përfundim se sëmundjet veneriane përhapen me shpejtësi të jashtëzakonshme.

Këto sëmundje barten kryesisht nëpërmjet prostitucionit, homoseksualizmit, amoralitetit dhe përmjet marrëdhënieve të tjera seksuale.

Ekzistojnë edhe mënyra të tjera të bartjes së këtyre sëmundjeve, edhe pse janë më pak të rëndësishme në krahasim me mënyrën e parë, e këto janë marrëdhëniet e ndaluara seksuale të cilat mund të reduktohen në këto:

1. Marrëdhënia me burrin ose me gruan e infektuar, nëpërmjet marrëdhënieve të paligjshme seksuale, me anë të prostitucionit, të homoseksualizmit, e të ngjashme;
2. Kalimi i mikrobrit në embrion, sikur që ngjan me sifilizin dhe me herpesin, ose gjatë lindjes, siç është rasti me triperin, me klamidian, e po ashtu me herpesin, përmes kontaktit të sekretit të tajitur nga vagina dhe nga gryka e mitrës të sëmura me këto sëmundje, me trup dhe sy;
3. Bartja përmes gjakut. Kjo ngjan me sifilizin dhe me sida-n;
4. Rrallëherë këto sëmundje barten edhe përmjet kontaktit me sipërfaqen e lëkurës së të sëmurit dhe me organet e tij;
5. Sëmurja e punëtorëve mjekësorë në laborator ose në spital. Revista mjekësore "Lanset", në numrin e saj të botuar më 24 mars të vitit 1984, faqja 676, përfshin: "Rasti i parë i sëmurjes nga sida u zbulua tek një nëpunës i spitalit që nuk ishte i njohur me marrëdhënie të shthurura seksuale. Po ashtu, është shënuar një numër i madh rastesh i të sëmurëve nga sëmundjet veneriane dhe nga sëmundjet e tjera ngjithëse, gjatë kontaktit me të sëmurin, me gjakun e tij dhe me pjesët e trupit. Ndonjëherë shkak i kësaj ishte autopsia e kufomave. Megjithatë ky është shkak shumë i rrallë.

Domethënë, shkak i përhapjes së këtyre sëmundjeve veneriane është shtimi i zinasë (prostitucionit), i homoseksualizmit, i

marrëdhënieve seksuale me të afërmit dhe çdo lloj i seksit anormal, për çka kemi folur më gjerësisht.

All-llahu ﷻ te njeriu krijoi nevojën për seks, sikur që krijoi edhe nevojën për ushqim. Për të kënaqur secilën nga këto, njeriut ia ka dhuruar ndjenjën e kënaqësisë. Kënaqësia gjatë marrëdhënieve seksuale, sikur që thotë imam Ebu-Hamid el-Gazaliu, në kaptinën për martesën, në librin e vet “Ringjallja e njohurive fetare”: “...është kënaqësia më e ëmbël, vetëm sikur të kishte zgjatur më shumë...”

All-llahu ﷻ nuk i ka kujtuar këto instinkte te njeriu pa arsye. Instinkti për ushqim ka rolin e ruajtjes së njeriut (individit), derisa instinkti për seks ka rolin e ruajtjes së llojit. Ndërsa ruajtja e llojit ka prioritet ndaj ruajtjes së individit.

Është më se normale që mashkulli madhor dhe gruaja e moshës madhore të përpiqen për ta kënaqur këtë epsh natyror, të cilin All-llahu ﷻ ua krijoi, që në këtë mënyrë të shumohen dhe ta ruajnë llojin e vet.

Ibn El-Kajjimi, në librin e vet “Et-Tibjan fi aksamil-Kur’an” thotë: “Mandej, kur All-llahu ﷻ dëshiroi t’i shumojë pasardhësit e tyre (pasardhësit e Ademit dhe të Havës) në Tokë, atëherë ua dhuroi ngrohtësinë e epshit, zjarrin e dashurisë dhe të dëshirës, dhe e frymëzoi secilin prej tyre me nevojën për t’u bashkuar me partnerin e vet, prandaj ata u bashkuan ashtu siç ishte e caktuar.” Ibn El-Kajjimi më tutje thotë: “Pastaj All-llahut ﷻ me urtësinë e Vet dëshiroi që shprehjes së epshit t’ia caktojë faktorët më të fortë nga brenda dhe nga jashtë dhe asaj ia bëri figurën të cilën e zbukuroi në sytë e atij që në të shikon dhe e bëri që ta dëshirojë atë. Mëpastaj, Ai deshi që njëri-tjetrit t’i afrohen përmes zingjirit të epshit, të dashurisë, prandaj secili nga ata fortësisht dëshiroi të bashkohet me shokun e vet dhe së bashku me të të jetojë, që All-llahu ﷻ të krijojë atë që është e caktuar. Mandej All-llahu ﷻ deshi që njëri prej tyre të jetë vendi i mbjelljes, e tjetri vend i farës dhe lëngjet e të dyve të bashkohen në një vend rreptësisht të caktuar.”

Mirëpo All-llahu ﷻ këtë nuk ia la rastësisë dhe as nuk lejoi që të takohet cildo mashkull me cilëndo femër, pa kurrfarë rregulli dhe

kushti. Përkundrazi, All-llahu ﷻ për këtë hartoi rrugë të caktuar, në të cilën i thërret njerëzit dhe në të cilën i nxit dhe i inkurajon. Kjo është rruga e martesës.

Pas përmendjes së grave me të cilat burri e ka të ndaluar të martohet, në suren En-Nisa, ajetet 22-23², All-llahu ﷻ thotë:

“...Ju janë lejuar pos këtyre (që u përmendën), të tjerat që t'i merrni në pasurinë tuaj (me nikah) duke pasur për qëllim bashkëshortësi, e jo prostitucion (zina).” [En-Nisa: 24]

Islami pra e ka ndaluar murgërinë, ndërsa e ka urdhëruar martesën dhe në të nxit dhe inkurajon.

I Dërguari ﷺ thotë: *“O djem, kush prej jush është në gjendje të martohet, le ta bëjë atë, sepse ashtu më lehtë do ta ruajë shikimin e vet dhe organin e vet gjenital, e kush nuk ka mundësi ta bëjë këtë, le të agjërojë, ngase agjërimi është mbrojtës i tiji (më i mirë).”* (Transmetojnë të gjashtit: Buhariu, Muslimi, Ebu Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Maliku)

Në hadithin tjetër, i Dërguari ﷺ thotë: *“Martesa është sunneti im dhe kush dëshiron të jetë në rrugën time le ta zbatojë sunnetin tim.”* (Transmeton: Ebu Ja'la)

I Dërguari ﷺ thotë: *“Kush është në gjendje që të martohet dhe këtë nuk e bën, ai nuk është prej nesh.”* (Transmeton: Daremiu, Ebu Davudi dhe Dejlemiu)

I Dërguari ﷺ thotë: *“Nëse ju vjen (si kërkues) ai me imanin*

² “Mos u martoni me ato gra, me të cilat qenë martuar prindërit tuaj, me përjashtim të asaj që ka kaluar (para islamizmit), pse ajo ishte turpësi, përbuzje e traditës.” “U janë të ndaluara juve (të martoheni me): nënat tuaja, bijat tuaja, motrat tuaja, hallat tuaja, tezet tuaja, bijat e vëllaut tuaj, bijat e motrës, nënat tuaja që ju kanë dhënë gjë, motrat nga gjiri, nënat e grave tuaja e të lindura (prej tjetër babai) nga gratë tuaja me të cilat patët kontakt me to (me gratë), atëherë ska pengesë (të martoheni me ato vajza) dhe, (janë të ndaluara) gratë e bijëve tuaj që janë të lindjes suaj (jo të bijëve të adoptuar) dhe të bashkoni (përnjëherë në një nikah) dy motra, përpos asaj që ka kaluar. Vërtet, All-llahu falë shumë, është Mëshirues i madh.” [En-Nisa: 22-23]

dhe besimin e të cilit jeni të kënaqur, martohuni me të. Nëse këtë nuk e bëni, do të paraqitet çrregullim i madh dhe rrëmujë në Tokë.” (Transmeton: Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)

I Dërguari ﷺ thotë: *“Martohuni dhe shumohuni, sepse unë do të krenohem me ju para popujve të tjerë.”* (Transmeton: Bejkekiu dhe Ibn Merdevejh).

I Dërguari ﷺ thotë: *“Kjo botë është kënaqësi kalimtare, e kënaqësia më e mirë e kësaj bote është gruaja e hajrit (e mirë).”* (Transmeton: Muslimi dhe Nesaiu)

I Dërguari ﷺ thotë: *“Martohuni me gra të dashura dhe fertile, sepse unë me numrin tuaj do të krenohem (në Ditën e Gjykimit).”* (Transmeton: Ebu-Davudi dhe Nesaiu)

Ibn Abbasi i ka thënë Ibn Xhubejrit: **“Martohu! Me të vërtetë, njeriu më i mirë i këtij Ummeti ka pasur më së shumti gra.”** (Mendon për të Dërguarin ﷺ) (Transmeton: Buhariu)

I Dërguari ﷺ thotë: **“Nuk ka murgëri në Islam.”** (Transmeton: Ahmed i dhe Tirmidhiu). Ndërsa në rivajetin e Taberaniut qëndron: **“Me të vërtetë murgëria nuk na është përcaktuar.”** - **“All-llahu ﷻ murgërinë na e zëvendësoi me fenë e lartësuar (Islamin).”**

Nga Se`ad ibn Ebu Vekkasi, transmetohet që ka thënë: **“Sikur i Dërguari ﷺ të mos ia kishte ndaluar murgërinë Uthman ibn Madh`umit, ne do të ishim tredhur.”** (Transmeton: Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu).

Kur Akkaf ibn Bishr et-Temimi kishte hyrë te i Dërguari ﷺ, i Dërguari ﷺ e kishte pyetur a ka grua apo robërshë. Kur Akkafi i kishte dhënë përgjigje negative, edhe pse kishte qenë i pasur, i Dërguari ﷺ i kishte thënë: **“Ti atëherë je vëlla i shejtanit. Po të kishe qenë i krishterë do të kishe qenë një nga murgjit e tyre. Sunneti ynë është martesë. Më të këqinjët në mesin tuaj janë të pamartuarit. A jeni duke u tallur me shejtanin? Shejtani nuk ka armë më të fortë kundër besimtarëve sesa gratë. Përveçse kundër të martuarve, ata janë të mbrojtur nga**

prostytucioni (zinaja).” (Transmeton: Ahmedi)

I Dërguari ﷺ duke iu drejtuar grave, u kishte thënë: *“Nuk kam parë që dikush me besim dhe me mendje më të dobët, mund të ngadhënjë mbi njerëzit e arsyeshëm më shumë se ju.”* (Transmeton: Buhariu dhe Muslimi). Imam Gazaliu, në librin e tij “Ringjallja e shkencave fetare,” në kaptinën për martesën, thotë: *“Kjo është për shkak të instinktit të epshtit.”*

Dobitë e martesës janë të shumta: ajo është mënyra më e mirë e ruajtjes së shikimit dhe të organit gjenital, prandaj Islami e quan “mbrojtje”, kurse të martuarit “të mbrojtur” (muhsanin), sepse ajo i ruan nga zinaja. Qëllimi i fundit i martesës është shumimi dhe ruajtja e llojit njerëzor. Prandaj i Dërguari ﷺ nxiste martesën me gratë e këndshme dhe fertile dhe në numrin sa më të madh të fëmijëve, duke na lajmëruar se do të krenohet me këtë Ummet në Ditën e Gjykimit, për shkak të numrit të tyre të madh.

All-llahu ﷻ thotë: *“O ju njerëz! Frikohujuni Zotit tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan shumë burra e gra....”* [En-Nisa: 1]

“O ju njerëz, vërtet, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre...” [El-Huxhurat: 13]

“Dhe Ai nga uji (fara) krijoi njeriun, e bëri atë të ketë fis dhe të ketë miqësi. Zoti yt ka mundësi të jashtëzakonshme.” [El-Furkan: 54]

“Dhe nga faktet (e Madhërisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.” [Er-Rrum: 21]

“Allahu krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja djem e nipa...” [En-Nahl: 72]

“...Ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për ato...” [El-Bekare: 187]

All-llahu ﷻ caktoi martesën si rrugë të vetme të drejtë për kënaqjen

e këtij epshi të lindur të njeriut. Në mënyrë që ky të jetë faktor formimi, ndërtimi dhe faktor i mbushjes së Tokës me të mira, me bereqet dhe me pasardhës, e jo që të shkatërrojë dhe ta rrënojë, siç ndodh kur ky epsh drejtohet kah rruga e shfrenimit, e amoralitetit, e prostitucionit dhe kah llojet e seksit anormal.

Allahu ﷻ ndalon prostitucionin dhe çdo gjë që shpie drejt tij.

All-llahu ﷻ thotë: *“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ajo është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe!”* [El-Israë: 32], dhe urdhëron në ruajtjen e organit seksual dhe në uljen e shikimit. Prandaj është një nga veçoritë e robërve të singertë të All-llahut *“...Dhe që nuk bëjnë amoralitet...”* [El-Furkan: 68]. E një nga veçoritë e besimtarit është *“...dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime)”* [El-Mu`minun: 5]. Po ashtu, një nga veçoritë e besimtarit është: *“Është e sigurtë se kanë shpëtuar besimtarët; ata që janë të përlurur dhe të kujdesshëm gjatë faljës së namazit dhe ata të cilët i shmangen kotësisë (fjalë a punë) dhe ata të cilët rregullisht e japin zekatin dhe ata të cilët e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime), me përjashtim ndaj grave të tyre (me kurore) dhe ndaj atyre (robërshave) që i kanë në pronësinë e vet, për të cilat nuk janë të qortuar, e kush kërkon përtej tyre (dëfrim nga të ndaluarat), të tillët janë ata që kanë shkelur norma të caktuara.”* [El-Mu`minun: 1-7]

Prandaj Islami shfrytëzon të gjitha mjetet në luftë kundër zinasë (prostitucionit), në mënyrë që muslimanët të mos bien në të. Për këtë arsye e nxit dhe e inkurajon martesën dhe e ndalon zinanë (prostitucionin), tregon në rrezikun e saj dhe ndalon çdo gjë që shpie drejt saj. All-llahu ﷻ urdhëron të ulet shikimi:

“Thuaju besimtarëve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre...” [En-Nur: 30]

“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet e tyre, të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme, le t'i vënë shamitë mbi

krabharorin e tyre, dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveç burrave të vet, baballarëve të vet ose baballarëve të burrave të vet, djemve të vet ose djemve të burrave të vetë, vëllezërve të vet ose djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmenden) dhe robërshave të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt që nuk ndiejnë nevojë për femra, ose fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre. Pendohuni të gjithë tek All-llahu, o besimtarë, në mënyrë që të gjeni shpëtim.” [En-Nur: 31]

Islami e ndalon përzierjen e meshkujve me femra dhe rreptësisht e ndalon vetmimin e mashkullit me femrën e cila nuk është mahrem për të. Urdhëron hixhabin dhe ua ndalon grave të të Dërguarit ﷺ që ta zbukurojnë zërin e tyre gjatë bisedës, që kjo të mos e bezdisë atë zemra e të cilit është e sëmurë. Ndalon hyrjen te gratë që nuk i kanë burrat prezentë, etj.

Islami rreptësisht e ndalon prostitucionin (zinanë), lloji më i rëndë i të cilit është zinaja me bashkëshorten e fqinjit dhe përshekruan pamjet e tmerrshme të dënimit të prostitutave, të cilat në zjarrin e Xhehennemit me mundime do të pinë gjakun dhe qelbin që do të dalë nga organet e prostitutave.

Islami, po ashtu, ndalon të gjitha format e seksit të shfrenuar. I Dërguari ﷺ ka ndaluar që njeriu të kontaktojë me gruan e vet në rektum (nga prapa në vrimën anale) dhe ky akt konsiderohet mëkat i madh dhe krahasohet me shkuarjen te falltori. Kur`ani dhe Sunneti e ndalojnë njeriun të kryejë marrëdhënie me bashkëshorten e vet në periudhën e hajzit (të menstruacioneve) dhe këtë e konsiderojnë të dhimbshme dhe të pahijshme. All-llahu ﷻ e qortoi popullin e Lutit dhe i përmbysi rrafsh me tokë, ngase homoseksualizmi sipas të mësuarit Islam është një nga mëkatet më të mëdha dhe më të rrezikshme.

I Dërguari ﷺ ka ndaluar të dëgjohen këngëtarët dhe valltarët dhe këtë e konsideron djep të zinasë. Islami po ashtu e ndalon

konsumimin e alkoolit dhe të drogës. Nuk ka dyshim se alkooli dhe droga janë faktorë shumë të rëndësishëm në përhapjen e prostitucionit, të homoseksualizmit, të marrëdhënieve seksuale jolegjitime dhe të dhunimit. Sipas statistikave zyrtare të organizatave ndërkombëtare për shëndetësi, të cilat i transmetojmë nga Dilli Millo (26/6/1980), 50% nga numri i përgjithshëm i dhunimeve dhe i keqtrajtimeve dhe 86% nga numri i përgjithshëm i vrasjeve ndodhin nën ndikimin e mjeteve dehëse.

Shkurtimisht, Islami nga të gjitha anët i hap dyert e martesës, në të nxit dhe inkurajon, dhe fortësisht dhe me vendosmëri i mbyll të gjitha dyert e tjera. Islami nuk i ka lënë asnjë rrugë besimtarit për të mbërritur deri te zinaja. Ia ka mbyllur të gjitha hyrjet dhe ka ndaluar çdo gjë që në çfarëdo mënyre çon kah prostitucioni.

Mu për këtë arsye problemi i sëmundjeve veneriane nuk u lajmërua në vendet muslimane, përveç se në periudhën kur muslimanët u larguan nga feja e tyre dhe nga ligjet e Zotit të tyre dhe kur pranuan ligjet e të pafeve, të cilat lejojnë amoralitetin, shfrenimin dhe lartësojnë prostitucionin dhe zinanë.

Përkundër të gjithave, mjediset islame, pa marrë parasysh se a janë ato në Afrikë a në Azi, ku jetojnë arabët ose joarabët, në Amerikë a në Evropë, më pak janë goditur nga sëmundjet gjenitale, siç paraqitet në librin “Sëmundjet veneriane në tokat e vendeve të nxehta,” autor i së cilës është Eraja Vebint dhe Usaba (botuar 1980).

Autori i veprës së përmendur pohon se ndalimi i përzierjes së meshkujve me femra dhe hixhabi sjellin deri te pakësimi i sëmundjeve veneriane në mjediset në të cilat këto praktikohen, edhe pse në mjediset e tilla gjenden vatrat e fesadeve (ngatërresave) me prostitutat. Prandaj përqindja e grave të sëmura muslimane është shumë e vogël, në krahasim me gratë e tjera në botë.

Sa u përket meshkujve në botën islame, ata më tepër u janë ekspozuar këtyre sëmundjeve sesa gratë, për shkak të trajtimit të çuditshëm që ua bën shoqëria këtyre pyetjeve, duke konsideruar se zinaja e mashkullit është shumë më e lehtë sesa zinaja e gruas.

I njëjti libër përmend se synetimi, edhe pse nuk zvogëlon

sëmundjet e sifilizit e të triperit, madje edhe tek ata që bëjnë zina, ai zvogëlon sëmurjet nga herpesi, nga i thati (ulkusi), nga tumori i kanaleve urinare dhe nga inflamacioniet që paraqiten tek të sëmurët me lëkurëz. Qëndrimi islam ndaj epsheve seksuale është i përkorë. Imam Gazaliu numëron dobi të shumta të këtij epshi, të cilin All-llahu ﷻ e mbolli në njeriun, me kusht që konsumohet përmjet martesës. Së pari është ruajtja e llojit të njeriut dhe shumimi i njerëzve, prej çka varet ekzistenca e njeriut në Tokë deri te fundi i kësaj bote i caktuar nga All-llahu. Së dyti, është mbrojtja nga shejtani, të thyerit e lakmisë, pengimi i sulmeve të epshit, ulja e shikimit, ruajtja e organit gjenital dhe në fund, largimi nga sëmundjet veneriane.

Së treti, është kënaqësia e marrëdhënieve seksuale, e cila besimtarit ia përkujton kënaqësinë e marrëdhënieve seksuale në Xhennet, çka ia shton atij dëshirën për këtë kënaqësi dhe e nxit atë në bërjen e veprave të mira dhe në largimin nga të këqijat. Duke e marrë parasysh se këto kënaqësi të kësaj bote janë të frymës së shkurtër dhe kalimtare, ndërsa kënaqësitë e Xhennetit janë të vazhdueshme dhe të përjetshme, atëherë këto na i përkujtojnë ato. Mandej Gazaliu thotë: “Shiko vetëm në urtësinë e All-llahut, mandej mëshirën, precizitetin, se si në një shtytje Ai dha dy jetëra: të brendshmen dhe të jashtmen. Jeta e jashtme është jeta e njeriut përmes ekzistencës së llojit të vet, çka paraqet vazhdimësinë e ekzistimit të tij. Ndërsa jeta e brendshme është jeta e asaj bote. Me të vërtetë, kjo kënaqësi e paplotë kalimtare shton dëshirën për kënaqësinë e tërësishme dhe të amshuar. Në këtë mënyrë ajo nxit në ibadet dhe kjo është rrugë e vetme deri te kjo e dyta. Kështu, njeriu me dëshirën e vet të fuqishme për kënaqësitë e kësaj bote, ia lehtëson vetes përpjekjet për atë çka do ta çojë deri te kënaqësia e amshuar e Xhennetit.

Dobia e katërt, pasqyrohet në atë që martesë, me të cilën frenohet shtytja e epshit, zë vend shumë të rëndësishëm në fe për çdokë të aftë për martesë, i këtillë është rasti me shumicën e njerëzve. Sepse nëse epshet zgjohen dhe forcohen, e nuk ekziston fuqia e besimit e cila do t'i frenonte ato, ato padyshim do të çojnë në amoralitet. Për

këtë na ka tërhequr vërejtjen i Dërguari ﷺ, me fjalët: ***“Përderisa nuk e bëni këtë, në tokë do të shfaqet çregullim i madh”.***

Në këtë mënyrë dijetarët islam flasin për dobritë e këtij epshi, nëse ai drejtohet në rrugën e caktuar. I Dërguari ﷺ ka treguar për njeriun që do të shpërblehet për marrëdhëniet e veta seksuale, me fjalët... ***“Edhe në mardhëniet tuaja seksuale ka sadaka.”*** As’habët thanë: “A do shpërblehet ndonjëri nga ne edhe për marrëdhëniet me bashkëshorten e vet? I Dërguari ﷺ tha: ***“Po. Çfarë mendoni nëse këtë do ta bënte në mënyrë të palejuar, a do ta meritonte dënimin? Gjithashtu, nëse këtë e bën në mënyrë hallall do të jetë i shpërblyer.”***

Qëndrimi i këtillë ndaj seksit nuk ekziston në asnjë religjion, e as në cilindo civilizim ose popull, përveç në fenë islame. Marrëdhënia seksuale bëhet ibadet dhe me të arrihet shpërblim i madh. Kjo nxitje në këtë kontekst bëhet shkas për të menduar të mirat e Allahut ﷻ dhe për mënyrat e arritjes deri te bukuritë e Xhenetit.

Për dallim nga këto, në religjionet e tjera, e veçanërisht në krishterim, hasim në qëndrim tërësisht të kundërt ndaj seksit. Krishterimi shikon me dyshim në nxitjen seksuale, edhe nëse kjo ka të bëjë me kanalizimin e saj nëpërmjet martesës. Tek ata murgëria dhe asketizmi janë më të mira sesa martesa, gjë që ka sjellë deri te përhapja e zinasë (e prostitucionit) dhe e seksit anormal në mesin e vetë murgjve dhe të priftërinjëve.

Nga të dhënat e mësipërme, mund të përfundohet se shkaqet e përhapjes së zinasë dallojnë nga vendi në vend dhe të gjitha këto mund të përmbledhen nën këto pika:

1. Përhapja e botëkuptimeve materialiste, sidomos në perëndim dhe largimi nga feja dhe nga parimet morale;
2. Përhapja e të ashtuquajtrit “revolucion seksual”, që paraqet revolucion kundër të gjitha feve. Këtë revolucion e kanë planifikuar hebrejnë, të cilët këtë haptazi e paraqesin në “Protokollet e mendimtarëve cionistë”;
3. Zotërimi i hebrejnëve me mjetet e informimit dhe me qendrat për udhëheqje, kështu që seksi është bërë dukuri normale nga e cila nuk duhet turpëruar, kurse pastërtia dhe dëlirësia janë diçka prej të

cilave në Perëndim duhet turpëruar;

4. Nxjerrja e gruas nga shtëpia në vendet e punës, me vetëdashje, e nganjëherë përkundër dëshirës së saj. Është shfaqur një numër i madh studimesh shkencore për punën e gruas, që tregojnë se ky është shkak për shtimin e zinasë (prostitucionit). Libri më i rëndësishëm është: “Shfrytëzimi seksual i gruas së punësuar” (The sexual harassment of women on the job) i autorit Lin Fari, citatet e të cilit i kemi përdorur në librin tonë “Gratë e punësuar në mizan”. Në të njëjtin libër, po ashtu, kemi cituar citate nga revistat perëndimore, sikur që është News Week, në numrin e botuar më 17 mars të vitit 1980, në të cilin është paraqitur një studim komplet me titullin “Keqpërdorimi i seksit në zyre” (Abusing Sex at The Office);

5. Dalja e gruas në punë ka sjellë deri te zvogëlimi (pakësimi) i kujdesit ndaj fëmijëve nga nënat e tyre. Në raportin e Organizatës Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Shëndetësisë qëndron se çdo fëmijë ka nevojë për kujdesin e vazhdueshëm të nënës së vet tri vitet e para. Këtë e kanë vërtetuar dhjetëra zbulime mjekësore në Evropë dhe në Amerikë. Mungesa e ngrohtësisë dhe e kujdesit të nënës, ka sjellë deri te shfaqja e gjeneratës të karakterizuar nga pasiguria, nga hutia, gjakftohtësia, nga përdorimi i drogës dhe nga përhapja e valës së terrorit, nga keqtrajtimet, nga dhënia pas seksit, pas alkoolit dhe në fund – nga vetëvrasja;

6. Dalja e gruas në punë ka shkaktuar jostabilitetin e saj dhe shkatërrimin e familjes. Sipas të dhënave zyrtare në Amerikë, çdo të tetën familje e ushqen gruaja, ose pse ajo është nënë virgjëreshë (ky është pseudonim për gruan e cila kurrë nuk ka qenë e martuar dhe ka fëmijë, çfarë pseudonimi i çuditshëm, i cili vetvetiu flet për kontradiktat e shoqërisë perëndimore) ose për shkak të divorcit (ndarjes), ose për shkak të braktisjes dhe të ikjes tek i ati;

7. Punësimi i gruas ka sjellë deri te vala e habitshme e keqtrajtimit të fëmijëve. Në revista dhe libra janë paraqitur dhjetra studime dhe referate “mbi keqtrajtimin e fëmijëve” (Abused Child). Më së shpeshti këto keqtrajtime bëhen aq të ashpra, saqë të shkaktojnë vdekje ose dëmtim të përhershëm të fëmijëve. Edhe më i

habitshëm është fakti se ky keqtrajtim është i përcjellur me aktivitete seksuale me djalën apo me vajzën, nga i ati ose nga të afërmit e saj. Revista mjekësore Hextagon Vol. 6/1978, pohon se nuk ekziston asnjë spital në Evropë dhe në Amerikë, në të cilat nuk gjenden bile disa fëmijë të rrahur ashpër nga nënat e tyre, e nganjëherë edhe nga babai i tyre. Në vitin 1967, në spitalet britaneze janë sjellë më shumë se 6500 fëmijë, të cilët janë rrahur aq fortë, saqë 20% kanë vdekur nga lëndimet e rënda. Qindra prej tyre kanë mbetur të verbër dhe qindra të tjerë kanë mbetur memecë. Mijëra fëmijë gjatë vitit bëhen abnormalë, mentalisht të prapambetur dhe të palëvizshëm për shkak të goditjeve të forta. Studimet shkencore tregojnë se shkak për këtë është lodhja e tepërt e nënës, e cila punon jashtë shtëpisë dhe e cila për shkak të kësaj përjeton pakënaqësi të mëdha në jetën e vet familjare, çka i ka shndërruar ato në egërsira që i keqtrajtojnë fëmijët e vet.

8. Përhapja e mjeteve për ndalimin e shtatzënësisë. Frika nga shtatzënësia ishte një nga faktorët kryesor që ndalonin gruan nga zinaja. Mirëpo kur ky faktor humbi, prostitucioni nga mungesa e vetëdijes fetare solli deri tek i ashtuquajtur i “emancipim i gruas,” dhe te barazimi i saj me burrin në sjelljen e tyre jonjerëzore dhe shfrenuese.

9. Përhapja e informacioneve mbi jetën seksuale, përmes të gjitha mjeteve të informimit, nëpërmjet shkollimit, duke theksuar, veçanërisht në perëndim, rëndësinë e parandalimit të shtatzënësisë dhe shmangien e sëmundjeve gjenitale, por duke bërë seks kudo që të paraqitet rasti.

10. Përhapja e rrjetit tregtar të prostitucionit në planin botëror. Prostitucioni konsiderohet shkaktar kryesor i sëmundjeve gjenitale në vendet në zhvillim (të botës së tretë), kurse liria seksuale e cila i ka përfshirë të gjitha shtresat e shoqërisë perëndimore është shkaktar kryesor i këtyre sëmundjeve në perëndim.

11. Turizmi: numri i turistëve në vitin 1975 ka arritur shifrën prej 215 milionë. Ky numër sot është rritur, por nuk posedojmë të dhënat e tanishme. Sidoqoftë, vendet turistike, sikur që janë Spanja dhe Portugalia, kanë numër më të madh abortimesh në botë, në

krahasim me numrin e banorëve. Numri i abortimeve gjatë këtij viti arrin shifrën prej një milioni. Këtu është fjala për abortimet qëllimisht të shkaktuara, e jo për abortet e vetvetishme. Shkaku i rritjes së abortimeve në Spanjë dhe në Portugali është fakti se banorët e tyre janë katolikë, ndërsa katolicizmi ende nuk e ka lejuar parandalimin e shtatzënësisë, prandaj vajzat e Spanjës kanë më pak përvojë në parandalimin e shtatzënësisë nga moshataret e veta në vendet e tjera të Evropës. Nga i njëjti shkak, zbulojmë që numri i abortimeve të qëllimshme në Amerikën Latine arrin 3 milionë në vit, sepse banorët e Amerikës Latine gjithashtu janë katolikë e në shkollat e tyre nuk mbahen orë mësimi për mjetet e parandalimit të shtatzënisë.

12. Udhëtimi me qëllim punësimi. Numri i të shpërngulurve për punë e ka arritur numrin prej 6 milionë punëtorësh në vitin 1975 dhe shumica e tyre jetojnë pa familjet e veta dhe në gjendje shumë të keqe psikike dhe sociale. Vajzat në mesin e tyre bien si viktimë e tregtisë botërore me prostitucion, që është tejet i përhapur në shumë vende të botës. Rinia në mesin e tyre nuk ka mënyrë tjetër për t'i kënaqur nevojat e veta seksuale, veçse përmes prostitutave.

13. Ekzistojnë veprimtari të caktuara, të cilat janë vetvetiu shkaktarë të përqindjes më të madhe të të sëmurëve nga sëmundjet veneriane, siç janë veprimtaria në fushën e dëfrimit dhe të zbavitjes në kafenetë, në bare, në hotele, me marinarë, me stjuardesa, e të ngjashme. Të gjithë këta me veprimtarinë tyre bëhen kandidatë potencialë për t'u sëmurë me këto sëmundje.

14. Në mjediset ku kërkohen shuma të mëdha për meher dhe kushte të veçanta për martesë arrihet deri te përqindja më e madhe e sëmundjeve veneriane, ngase të rinjtë nuk gjejnë mënyrë tjetër për t'i kënaqur epsheet e veta të papërmbajtura, përveçse me anë të zinasë. Meqë këto janë shumica vende ku mbahet edukata fetare, ata këtë mund ta realizojnë vetëm me vajzat që merren me prostitucion. Hulumtimet tregojnë se prostituat në Egjipt, në Tunis, në Iran, në Turqi, në Francë e në shtete të tjera janë të infektuara me sëmundje veneriane në përqindje prej 90% dhe 100%.

15. Sipas mendimit tim, shkaktarët e natyrës fiziologjike dhe

bakteriologjike konsiderohen sekondarë. Në shkaktarët fiziologjikë marrin pjesë zhvillimi i shpejtuar fizik i djemve dhe i vajzave dhe pjekuria seksuale e tyre e hershme. Sot në Perëndim koha e tyre e pjekurisë seksuale sillet rreth moshës 11 dhe 12 vjeçe, ndërsa kjo kohë vetëm para disa gjeneratash ishte mes 14 dhe 16 vjet, kryesisht 20. Sa i përket baktereve, këtu mendohet për shfaqjen e mikrobeve që janë rezistente në antibiotikë. Kështu, p.sh. dy e treta e të sëmurëve nga sifilizi në Azi, në Afrikë është pasojë e infektimit me mikrobe që janë rezistente ndaj penicilinës.

16. Pijet dehëse dhe droga gjithashtu konsiderohen si shkaktarë të përhapjes së sëmundjeve veneriane. Meqë alkooli dhe droga ia marrin vetëdijen njeriut, dhe njeriu në gjendje të tillë është i dhënë më tepër pas keqtrajtimit seksual, veçanërisht në stadiumin fillestar të ndikimit, para se të dehet tërësisht, ai bëhet seksualisht i paaftë.

Duke qenë se alkooli është shumë i përhapur nëpër vendet perëndimore dhe në shumë vende të tjera të botës dhe pasi shumica prej atyre që konsumojnë alkool këtë e bëjnë në tubime publike dhe në ahengje të ndryshme (100 milionë në SHBA dhe më tepër se 150 milionë në BRSS), na bëhet e qartë përse janë aq të shpeshta dukuritë e prostitucionit, zakonisht pas festimeve të tilla, ngase shumica e tyre përfundon me akte të prostitucionit.

SIDA

Sindroma e imuno-mungesës së fituar

I Dërguari 齋 thotë: ***“Kur në një popull përhapet dhe zgjerohet prostitucioni (zinaja), deri në atë masë, saqë ajo të bëhet baptazi, në të do të lajmërohen (shfaqen) murtaja dhe sëmundje të cilat nuk kanë ekzistuar në mesin e paraardhësve, të cilët para tyre kanë jetuar”*** (Transmeton: Hakimi, Ibn Maxhe dhe El-Bezzari).

“Sida është problem numër një për ministrinë e shëndetësisë në SHBA”, thotë Margaret Henkler, ministresha e shëndetësisë (revista amerikane “Time”, 4/7/1983).

“Unë veçanërisht brengosem për gjendjen e vëllezërve të mi që janë të shfrenuar seksualisht dhe të sëmurë nga sida, e të cilëve shoqëria refuzon t’u bëjë çfarëdo shërbimi, qofshin të mallkuar! Dr. Xhoshova, kryetar i grupit i të shfrenuarve seksualë në qytetin Sietëll, në SHBA (“Time” 4/7/1983).

Definicioni i Sëmundjes së SIDA-s (AIDS):

AIDS është fjalë e shkurtuar (Acquired Immune Deficiency Syndrom) për sindromën e imuno-mungesës së fituar.

Sida shfaqet me një numër të caktuar simptomesh, shfaqja e të cilave tregon se i sëmuri lëngon nga mungesa e imunitetit. Meqë mungesa e imunitetit mund të jetë trashëguese, është shtuar fjala (fituar) me të cilën nënkuptohet dallimi ndërmjet dy llojeve të imunitetit. Është e njohur po ashtu se imuniteti bie edhe tek të sëmurët nga disa lloje të kancerit dhe tek ata që marrin barna kimike për shërimin e tumoreve malinje dhe tek ata që për arsye shërimi të ndonjë sëmundjeje konsumojnë sasi të mëdha të prodhimeve të kortizonit dhe te personat që përdorin barna për zbutjen e imunitetit gjatë transplantimit të organit të caktuar.

Të gjitha këto grupe nuk i takojnë definicionit të sëmundjes së sida-s (sindroma e imuno-mungesës së fituar), sepse këtu bëhet fjalë për humbjen e imunitetit, që nuk është shkaktuar nëpërmjet rrugës mjekësore (pa përdorim të barnave) dhe të cilin i sëmuri nuk e ka trashëguar.

Sindroma e imuno-mungesës së fituar shkakton përhapje të viruseve dhe të baktereve me kërpudha të caktuara parazitare në trupin e të sëmurit, të cilat janë të njohura me emrin infektive oportuniste. Gjithashtu shfaqet edhe një lloj i rrezikshëm i tumorit malinj që quhet sarkoma e Kaposit.

Përfundimisht do të dëshironim të theksonim në definicionin e kësaj sëmundjeje, se të sëmurët nga sida kanë gëzuar më parë shëndet të plotë dhe se shumica e të sëmurëve kanë qenë meshkuj që janë sëmurë në periudhën e rinisë (20-35 vjet) dhe të cilët kanë qenë të dhënë pas seksit të shfrenuar. Megjithatë qëndrimi i fundit

nuk është aq i rëndësishëm, sepse kjo sëmundje është e përhapur në mesin e atyre që merren me prostitucion, e veçanërisht në mesin e prostitutave të Afrikës së Mesme. Gjithashtu është shumë e përhapur në mesin e atyre që konsumojnë drogë përmes injeksioneve (të kaltra) në venë.

Më vonë do të flasim për llojet e të sëmurëve nga kjo sëmundje.

Sëmundja e sida-s është temë kryesore e mjeteve të informimit në SHBA, pastaj në Evropë, e mëpastaj në vendet e tjera të botës. Sida paraqet frikë të re nga e cila tmerrohet civilizimi i shek. XX. Termi AIDS është bërë sinonim për murtajën, e cila shkatërronte në shek. XVIII dhe në disa shekuj përpara tij, kur murtaja rrëmbente jetërat e dhjetëra miliona njerëzish.

Kandida orale për “infeksionet kërpurdhore”

Përhapja e sida-s dhe përmasat e këtij problemi:

Kjo sëmundje nga vetë zanafilla e saj dallohej me shpejtësinë e përhapjes. Numri i të sëmurëve dhe i të goditurve dyfishohet gati çdo 6 muaj. Kur kjo sëmundje u lajmërua për herë të parë në vitin 1978 në Belgjikë, numri i të sëmurëve pothuajse nuk e kalonte numrin e gishtave të një dore (shtatë raste) dhe këto raste as nuk kanë qenë të karakterizuara fillimisht si raste të sida-s, por tek pas dy vitesh.

Në vitin 1979 lajmërohen rastet e para në Amerikë, të cilat u shënuan si raste të veçanta të rënies shumë të madhe të imunitetit, shkaktari i së cilës nuk dihej. Madje edhe në vitin 1981, kur në Amerikë u shënuan 58 raste të tilla, ato nuk njiheshin me emrin sida (AIDS), por si gjendje të veçanta të humbjes së imunitetit personal. Në vitin 1981 lajmërohet termi AIDS (sida) për sindromën e imuno-mungesës së fituar, e cila konsiderohet sëmundje ngjyese, pasi që këtë e zbuloi një mjek me emrin Gottlieb.

Më pas, raste të veçanta të sida-s janë shfaqur në Sudan, në Portugali, në Hong-Kong, në Japoni dhe në Tajlandë. Kryesisht shiriti Afrikan i sida-s (Afrika e Mesme-Zairja-Ruanda-Burundi-Kenia) konsiderohet më i rrezikshmi, ngase sida në këto vise të botës përhapet me shpejtësi të hatashme dhe kjo me siguri e tejkalon shpejtësinë e përhapjes së saj edhe në vetë Amerikë. Profesori i shkencave mbi viruset, Morion Askis, në universitetin Harvard, pohon, siç e transmeton këtë gazeta Amerikane “Time” (12/8/1985), se çdo i 20-ti në Afrikën e Mesme (Zonat Afrikane të sida-s), tani për tani është i infektuar me virusin e sida-s (do të thotë: 5% nga banorët e përgjithshëm).

Kjo do të thotë se edhe dhjetëra njerëz të tjerë do të molepsen me Sida-n në pesë vitet e ardhme në këto vende të botës. (Transmetuar nga gazeta “Time” 12/8/1985, faqe 48). Gazeta “Arab News” (19/1/1986), transmeton se hulumtuesit shkencorë në Bruksel kanë deklaruar se 6 % e banorëve të Zaires, të Kongos, të Ruandës dhe të Kenisë janë të infektuar me virusin e sida-s, dhe që tek 10% e bartësve të virusit do të shfaqen simptomat e sëmundjes në afat prej disa vitesh.

Leukoplakia e gjuhës

Llojet e njerëzve që sëmuren nga sida

Llojet e njerëzve që sëmuren nga sida dallojnë nga shteti në shtet. Në SHBA dhe në Evropë, në vend të parë janë ata që merren me seks të shfrenuar dhe këta përbëjnë 70% të të sëmurve. Derisa në Afrikën e Mesme, në Zaire dhe në vendet përreth zbulojmë se shumica e tyre janë ata që merren me prostitucion dhe ata që vazhdimisht i ndërrojnë partnerët, kështu që prostitutat janë burimi kryesor i kësaj sëmundjeje. Në këto vende, sida gati kufizohet në këto dy lloje (prostitutët dhe prostitutat). Në të njëjtën kohë, zbulojmë se raste më të pakta të sida-s, të cilat janë shënuar në vendet e siudhesës arabe, janë shkaktuar përmes transfuzionit të gjakut.

Klasifikimet e paraqitura në libra dhe në revista, të lidhura me kategorinë e njerëzve të sëmurë nga sida, në të vërtetë flasin për SHBA - të dhe për Evropën. Këto janë kategoritë që vijojnë:

1. Të shfrenuarit seksualë:

Këta përbëjnë 70-74% të numrit të përgjithshëm të të sëmurëve

nga sida në Amerikë dhe në Evropë. Villiëm Fog, drejtor i qendrës për mbikëqyrjen e sëmundjeve, në Atlantë, SHBA, duke folur për këtë kategori njerëzish, që në Britani quhen Harolds, kurse në Amerikë Gays (pederastët), siç transmeton gazeta "Time" (4/7/1984) thotë: "Këta njerëz nuk kënaqen të kryejnë marrëdhënie seksuale me numër të kufizuar shokësh, por këtë orvaten ta bëjnë me secilin që takojnë. Prandaj mesatarja e atyre me të cilët kanë marrëdhënie në një vit arrin 60 veta." Time (gazeta) në komentin e vet për fjalët e tij thotë: "Te këta njerëz seksi është përshëndetje, pas së cilës mandej pason biseda dhe përshëndetja e zakonshme." Numri i atyre seksualisht të shfrenuar në SHBA arrin shifrën 20 milionë, kurse në Britani çdo i pesti nga të martuarit pranon se është marrë me seks të shfrenuar, dhe ende e bën këtë. Nuk ka dyshim se ekzistojnë miliona njerëz në Evropë që krenohen me faktin se janë seksualisht të shfrenuar:

2. Narkomanët:

Këtu mendohet për ata që përdorin injeksione (të kaltra) duke i marrë në vena. Ata përbëjnë 17% prej numrit të përgjithshëm të të sëmurëve nga sida.

3. Transfuzioni i gjakut dhe i përbërësve të tij:

Raste të këtilla të të sëmurëve nga sida përbëjnë 2-4% prej numrit të përgjithshëm të të sëmurëve. Ata ndahen në persona të cilëve u është bërë transfuzioni i gjakut nga ndonjë shkak dhe në ata që janë të sëmurë nga hemofilia. Këta janë fëmijët që janë të sëmurë nga sëmundja trashëguese të cilën e bartin nënat e tyre, dhe e cila bartet vetëm tek pasardhësit meshkuj, sepse ajo bartet përmes kromozomit x. Pasi fëmija mashkull bart vetëm një kromozom x, sëmundja shfaqet tek ai, ndërsa fëmijët femra bartin dy kromozome x, kurse sëmundja gjendet vetëm tek njëri. Kjo sëmundje shkakton mungesën e faktorit 8, i cili është një prej shkaktarëve të koagulimit të gjakut. Nëse vjen deri te pakësimi i këtij faktori, atëherë do të vijë gjer te gjakderdhja e cila është e pamundur të ndalet, madje edhe në rast të një lëndimi më të vogël.

Retinopatia virusale

Për këtë arsye kjo materie e rëndësishme grumbullohet përmes organizatave të dhënësve vullnetarë të gjakut dhe u dhurohet fëmijëve të sëmurë në formë të injeksioneve që jepen në venë.

4-6% të rasteve nuk mund të klasifikohen në kategoritë e mësipërme.

Revistat, para dy vitesh, grupin Haiti e klasifikonin në grupin e veçantë. Haiti është ujdhesë në detin e Karaibeve, nën protektoratin frëng. Shumica e banorëve të tij janë me prejardhje afrikane dhe jetojnë në gjendje shumë të mjerë. Ujdhesa është e qetë dhe shumë

e bukur, prandaj e vizitojnë numër i madh turistësh nga Amerika dhe njëherit ka qenë edhe pushimore e të shfrenuarve seksualë.

Në fillim, institucionet shëndetësore kanë shënuar se ka pasur 5% të të sëmurëve nga sida në mesin e të shpërngulurve nga Haiti në SHBA (në Nju Jork, në Floridë dhe në vendet përreth). Nuk ishte e njohur përse ata ishin sëmurë nga sida, sepse nuk ishin të shfrenuar seksualisht dhe as nuk konsumonin mjete dehëse. Për një kohë të shkurtër mjekët zbuluan se ata kishin qenë të shfrytëzuar nga të shfrenuarit seksualë për një shumë fare të vogël të hollash, ngase gjendja e tyre e mjerë ka qenë shkak për të pranuar veprime të tilla. Për këtë arsye ky grup u klasifikua në mesin e të shfrenuarve seksualë dhe u bë si grup i veçantë.

Gjendjet të cilat nuk mund të klasifikohen në asnjërin prej grupeve të përmendura, mund të ndahen në grupet që vijojnë:

1. Prostitutat: Ato përbëjnë përqindjen më të madhe në Afrikën e Mesme dhe në vendet e veçanta të cilat janë të njohura për prostitucion, sikurse që janë Bangkoku në Tajlandë, Manila në Filipine, Najrobi në Keni. Janë bërë hulumtimet në këta të pafytyrë (të paturpë) dhe është konstatuar se përqindja më e madhe e tyre bartin sëmundjen e sida-s. (Dr. Herfy në librin AIDS). Në vitin 1985 hulumtuesit kishin vërejtur praninë e kësaj sëmundjeje në mesin e prostitutave në Amerikë dhe në Evropë. Ky u bë një problem i madh, veçanërisht për forcat e armatosura, sepse ushtarët kanë marrëdhënie të shpeshta me prostitutat.

2. Bashkëshortët e të sëmurëve nga sida: Numri i madh i bashkëshortëve të të sëmurëve nga sida, janë sëmurë gjithashtu. I sëmuri nga sida, nganjëherë është i martuar, megjithatë prapëseprapë merret me seks të shfrenuar, ose konsumon drogë apo bën zina. Rrallëherë ndodh që bashkëshorti të jetë viktimë e sida-s përmes transfuzionit të gjakut. Meqë virusi i sida-s bartet përmes kontaktit seksual, te shumica e bashkëshorteve të molepsura nga sida, lajmërohen po ashtu simptome të kësaj sëmundjeje.

3. Fëmijët e të sëmurëve nga sida: Përkrah fëmijëve të sëmurë nga sida përmes transfuzionit të gjakut ose për shkak të hemofilisë,

ekziston edhe një numër i caktuar fëmijësh që sëmuren nga sida për shkak të bartjes së virusit nga njëri prind.

Ky virus bartet gjithashtu edhe në embrion dhe për mënyrën e bartjes së tij në embrion ekzistojnë teori të shumta:

1 - Sperma në vete përmban virusin dhe me të infektohet embrioni menjëherë në stadiumin e vet të parë. Konsiderohet se një numër i madh i aborteve spontane bëhet nga kjo arsye;

2 - Virusi bartet nga gjaku i nënës në gjakun e embrionit përmes placentës, mandej përmes kërthizës deri te vetë embrioni;

**Nyjat e sarkomës së Kaposit të lokalizuara mbi
nofullën e poshtme dhe në qafë**

3 - Fëmija infektohet me virus gjatë lindjes dhe gjatë daljes së tij nga mitra përmes vagjinës së infektuar;

4 - Infektimi ndodh gjatë lindjes, gjatë prekjes direkte, dhe për shkak të lidhjes së fortë ndërmjet fëmijës dhe nënës ose babait (zakonisht para shfaqjes së simptomit të sëmundjes). Por mund të ndodhë që virusi të bartet te fëmija përmes gjirit gjatë gjidhënies:

5 - Është i mundur infektimi gjatë mbarsjes artificiale dhe i fëmijës nga epruveta. Kjo në të vërtetë, disa herë ka ndodhur në Austri. Në gazetën Esh-Sherkul—evsat (26/7/1985) është transmetuar lajmi, që njëri prej spitaleve në Australi ka bërë mbarsjen artificiale të katër grave me spermën e njeriut që e kishte dhuruar spermën e vet përmes bankës për spermë dhe mandej u vërtetua që ai ishte i sëmurë nga sida;

Janë të shënuara disa raste të punëtorëve të sëmurë në disa spitale

Sida zë vend të veçantë në Afrikën e Mesme, për shkak të përhapjes së gjerë të tumorit të njohur nën emrin sarkoma e Kaposit. Në Zaire, përqindja më e madhe e të sëmurëve është nga tumori i Kaposit, i cili arrin deri 13% prej numrit të përgjithshëm të të sëmurëve të këtij lloji në botë.

Ndërkaq, ky tumor zakonisht zhvillohet shumë ngadalë dhe godet personat e vjetër, kurse sida i godet personat e ri deri në moshën e pjekurisë (nga 20-49 vjet) dhe zhvillohet shumë shpejt, përhapet dhe e mbyt pacientin në afat prej dy e më së shumti tre vjet nga momenti i sëmurjes.

Rreziku i kësaj sëmundjeje në Afrikë ekziston për shkak të disa faktorëve. Para së gjithash, kjo sëmundje në Afrikë nuk është e kufizuar vetëm tek ata që merren me seks të shfrenuar, mandej, përhapja e jashtëzakonshme e prostitucionit, përkrah kësaj është edhe shkalla shumë e ulët e mbrojtjes shëndetësore. Mandej, është edhe numri i madh i të porsalindurve që sëmuren nga kjo sëmundje, ngase një numër i madh nënash janë veç të sëmura. Në një informatë qëndron se 36% të fëmijëve të Zaires janë me HIV pozitiv. (Daniell Viktor, Sida). Po ashtu, një prej arsyeve është dezinfektimi joadekuat i injeksioneve, madje edhe në ambulancat zyrtare. Prandaj roli i injeksioneve për shërim në bartjen e virusit të sida-s në Afrikën e Mesme është shumë i mundshëm. Kjo është e ngjashme me rolin e injeksioneve që jepen direkt në venë nga shfrytëzuesit e drogës të cilët nuk i dezinfektojnë injeksionet dhe një gjilpërë e përdorin për shumë persona.

Revista Amerikane "Time" (12/8/1985), paraqet që 5% e banorëve të përgjithshëm në "Brezin e sida-s", e bartin virusin e sida-s. Hulumtuesit nga Brukseli pohojnë se 6% të banorëve të Zaires, të Kongos, të Ruandës, të Kenisë dhe të Ugandës bartin virusin e sida-s, dhe se 10% e tyre do të sëmuren nga sida për disa vite të ardhshme.

Shpenzimet për SIDA-n

Sida nuk është vetëm sëmundje vdekjeprurëse, por është edhe sëmundje që kushton shumë shtrenjtë. Përkundër faktit që ende nuk ekziston bari adekuat (përgjegjës) për këtë sëmundje, shpenzimet e kujdesit të të sëmurit sillen mes 50000 dhe 150000 dollarë ("Time" 12/7/1985). Duke qenë se në Amerikë numri i të sëmurëve nga sida kalon 17000 dhe harxhimet mesatare të një të sëmuri sillen rreth 100000 dollarë, kujdesi i të sëmurëve nga sida, deri në fund të vitit 1985, i ka kushtuar qeverisë së SHBA-ve 1700 milionë dollarë. Nëse kësaj ia shtojmë humbjen e ditëve të punës të të sëmurëve e të tjerat, humbjet materiale kalojnë 5 miliardë dollarë. Nëse kësaj i shtohen harxhimet e hulumtimeve shkencore të lidhura për sida-n, dhe analizat e gjakut, të cilat janë të obliguara me rastin e marrjes së gjakut të secilit, atëherë këto shpenzime kalojnë dhjetëra miliardë dollarë, sidomos, nëse do t'i llogarisnim harxhimet e të sëmurëve nga sida dhe hulumtimet shkencore në atë fushë, në Evropë dhe në vendet e tjera të botës.

Frika është duke i përfshirë SHBA-të, Evropën dhe vendet tjera të botës

Rezultat i shtimit konstant dhe të shpejtë të sida-s është frika dhe droja që është duke u infiltruar në shoqërinë perëndimore. Revistat dhe gazetat, përherë e më shpesh transmetojnë demonstrata të të shfrenuarve seksualë në Amerikë, në Evropë, të cilët nga qeveria e tyre kërkojnë për t'i mbrojtur ata nga “murtaja e re” - sida.

Kaherë, ministresha për shëndetësi në SHBA, Margaret Henkler, ka deklaruar (4/7/1983) se sida është problemi kryesor i ministrisë për shëndetësi në SHBA.

Të vërtetën e ka thënë i Dërguari ﷺ, kur ka thënë: ***“Kur në një popull të lajmërohet zinaja dhe të përhapet deri në atë masë, saqë ajo të bëhet haptazi, në të do të përhapet murtaja dhe sëmundje që nuk kanë ekzistuar në mesin e të parëve që jetuan para tyre.”*** (Transmeton: Hakimi, Ibn Maxhe dhe El-Bezzari).

Ja, jemi duke parë se si sëmundjet e ndryshme, anomalitë dhe murtaja (termi murtajë përdoret për çdo sëmundje infektuese, edhe pse murtaja në bazë nënkupton sëmundjen ngjitëse që e shkakton mikrobi nga familja Pasteurela, të cilin e bartin morrat prej minjve në njerëz) po përhapen në mesin e atyre që haptazi bëjnë zina dhe të cilët janë zhytur në amoralitet.

Sarkoma e Kaposit

Në Amerikë, në Evropë dhe në vende të tjera të botës janë inkuadruar mjetet për informim dhe institutet e ndryshme shkencore në hulumtimin e kësaj sëmundjeje të habitshme dhe të enigmës vdekjeprurëse.

Ministria e shëndetësisë në SHBA boton buletinin e veçantë që flet kryesisht mbi sida-n. Buletini del çdo dy javë, që nga viti 1983. Në atë buletin paraqiten të gjitha rezultatet e zbulimeve të reja përkitazi

me sidën. Po ashtu, gati në të gjitha revistat mjekësore mund të haset artikulli i domosdoshëm ose referati mbi sida-n. Madje, gazetatat, radiot dhe TV stacionet, bëjnë gara se cili do të transmetojë lajmet e fundit të lidhura me sida-n.

Qeveria e SHBA-ve ka caktuar një numër të veçantë telefoni për përgjigjet në pyetjet rreth sida-s, i cili është në shërbim 24 orë. Numri i këtij telefoni është 800342 AIDS. Të gjitha thirrjet në këtë numër shkojnë në llogari të qeverisë amerikane, selia e së cilës është në Nju Jork. Unë personalisht kam thirrë në këtë numër në janar të vitit 1984 dhe i kam marrë të dhënat për sida-n, të cilat asokohe ishin më të rejat.

Të shfrenuarit seksualë i ka përfshirë një frikë e madhe, ngase për çdo moment presin t'i atakojë sida. Reagimet e tyre rreth kësaj sëmundjeje, e cila veçanërisht i atakon ata, janë të ndryshme. Shumica e tyre janë të sëmurë nga histeria. Disa kanë bërë vetëvrasje, kurse shumica janë plotësisht të zhgënjyer në jetë dhe kanë rënë në dëshpërim total, pasi që kanë vërejtur se një numër i caktuar personash me të cilët kanë pasur kontakte seksuale tani janë sëmurë nga sida. Prandaj edhe ata presin që në çdo moment të sëmuren nga sida. Janë të sigurtë se nuk do të shpëtojnë nga kjo sëmundje, prandaj shumë prej tyre edhe më tepër i kushtohen seksit dhe shthurjes.

Për të tjerët, goditja e sida-s ka qenë e dobishme dhe nga frika që të mos bien në kthetrat e sida-s, kanë pushuar të konsumojnë seks të shthurur. Frika nga sida ka shkuar aq larg, sa që shumë prostituta dhe narkomanë të rryem, prej frikës së madhe nga sida, kanë pushuar të merren me prostitucion dhe me përdorimin e drogës.

Gazeta "Ukaz" (11/11/1985), gazeta amerikane "Time" (12/8/1985) dhe shumë revista të tjera dhe gazeta, flasin se si në Holivud, në qytetin e kinematografisë, shumicën e ka kapluar frika, aq më tepër kur artisti i njohur Rok Hadson (i cili ishte shok i kryetarit amerikan Ronald Regan) u sëmur nga sida. Duke pasur parasysh se Hadsoni jetoi në Holivud, e Holivudi është qytet i njohur për amoralitetet e prostitucionit, ku pothuajse të gjithë banorët e tij kanë kontakte reciproke seksuale. Shumë prej filmave janë me

temë seksi dhe artistët në skena të ndryshme shpesh i puthin artistet. Frika vdekjeprurëse ka bërë që jeta e tyre të mbështetet në pilulat për qetësim nervash dhe për zbutje dhembjesh dhe në përdorimin e shtuar të mjeteve dehëse, siç janë kokaina dhe heroina.

Një stomatolog, i cili punon në Holivud, dhe i cili është anëtar i shoqatës “lufta kundër sidës”, deklaroi se nuk do të befasohej po që se shumë “yje të filmit” do ta proklamnin sëmurjen e tyre nga sida në disa muajt e ardhshëm. Ky stomatolog refuzoi për t’i treguar emrat e atyre për të cilët dyshohet.

Agjensitë botërore transmetojnë lajmin se si artistja e njohur Linda Evans, e cila e kishte puthur Rok Hadsonin në serialin e njohur “Dinastia”, jeton me frikë të madhe nga “puthja vdekjeprurëse”, pasi që mjekët zbuluan se virusi i sida-s ndodhet edhe në gjëndrat pështymore të të sëmurit. Kurse Rok Handsoni gjatë asaj puthjeje kishte qenë i sëmurë nga sida.

Kryetari i shoqatës së artistëve të Holivudit deklaroi: “Holivudi është qytet në të cilin të gjithë banorët e tij e pranojnë njëri-tjetrin në çdo kohë...” Andaj, është e domosdoshme që të merren masa adekuate kujdesi, siç është analiza e gjakut e të gjithë punëtorëve të kinematografisë, veçanërisht të artistëve dhe të artisteve, për t’u vërtetuar ekzistimi i virusit të sida-s në gjakun e tyre.

Frika i ka përfshirë gjithashtu edhe forcat e armatosura të Amerikës, saqë pushteti i Amerikës ka filluar të mendojë rreth planit të luftës kundër sida-s tek anëtarët e forcave të armatosura.

Të dhënat e deritanishme mjekësore tregojnë se personi në të cilin gjendet virusi (HTLV III) nuk ka mundësi shërimi, por ai virus mbetet përherë në trupin e tij. Personi i tillë e bart atë virus, dhe mundësia që të sëmuret nga sida ose nga sida fillestare (Pre AIDS), e cila manifestohet me gjëndra limfatike që përhapen shumë shpejtë në trupin e të sëmurit, është shumë e madhe.

Këta persona mund të jenë shkaktarë infektimi dhe të bartjes së sëmundjes tek të tjerët, edhe pse tek ta nuk duket asnjë gjurmë e sëmundjes.

Ata që janë bartës të këtij virusi dhe ata që janë të sëmurë nga sida,

ose nga sida fillestare, nuk bën ta dhurojnë gjakun e vet ose cilëndo pjesë të trupit të tyre, madje edhe pas vdekjes.

Sëmundja mund të bartet nëpërmjet marrëdhënieve seksuale, ose përmes përdorimit të injeksioneve të njëjta, ose përmes pështymës. Prandaj nuk duhet të përdoret brusha e huaj për dhëmbë, aparati për roje dhe gjëra të tjera personale. Sida mund të bartet nga njëri prej partnerëve të martuar të sëmurë nga sida, çka do të thotë se ajo mund të kalojë në embrionin e fëmijës.

Injeksionet mund të përdoren vetëm një herë, pastaj duhet të hedhen dhe të merren të reja.

Është e nevojshme të bëhet kontrolli, me të cilin do të verifikohej ekzistimi i virusit (HTLV III) te personat për të cilët dyshohet se do të mund t'i jenë ekspozuar këtij infektimi, sikurse që janë të shfrenuarit seksualë, ata që kanë kontakt me sida-n dhe ata që kanë marrë gjak para këtyre analizave.

Shkurtimisht për shkaktarët e SIDA- S

Shkenctarët pas përpjekjeve të mëdha arritën të zbulojnë virusin që shkakton sida-n. Ky virus i takon familjes së retrovirusëve dhe i ngjan virusëve që shkaktojnë kancerin e gjakut të llojit T te njeriu (HTLV I), me disa veçori të caktuara dhe dallon nga ata në disa imtësi, prandaj i është dhënë numri III, sepse ai është virusi i tretë i zbuluar nga kjo familje e virusëve (HTLV III).

Siç duket ky është i njëjti virus, i zbuluar nga Montanije dhe nga ekipi i tij në Francë, të cilin e quajtën virus i përcjellur me rritjen e gjëndrave limfatike – me Limfadenopati (LAV). Të njëjtin virus e zbuloi edhe dr. Lifi në San Francisko, të cilin e quajti virus të lidhur me sida-n, AIDS Related Virus (ARV).

Këto tre viruse (HTLV III), (ARV) dhe (LAV), janë të ngjashme me këto veçori të përbashkëta:

1. Veçanërisht i sulmojnë qelizat limfatike të grupit T, e posaqërisht T4;
2. Është vërejtur ekzistimi i trupave mbrojtës kundër këtyre tri virusëve, gati në të njëjtën përqindje tek disa grupe;
 - a) Te të sëmurët nga sida;
 - b) Te të sëmurët në fazën e parë, para sëmurjes nga sida;
 - c) Te të shfrenuarit seksualë që nuk janë sëmurë nga sida;
 - d) Te dhënësit vullnetarë të gjakut, nga Zairja;
3. Acidi ribonukleik (RNA) është lëndë trashëguuese tek të tri llojet e virusëve;
4. Të tri viruset janë të ngjashme, madje gati tërësisht identike nën thjerrëzën mikroskopike.
5. Analizat e shumta kanë treguar se gjeni që i bart vetitë trashëguuese te të tre viruset është tërësisht i njëjtë dhe se është e pamundur të dallohet.

Për shkak të të gjitha këtyre arsyeve, mendimi i hulumtuesve është se të tre këto viruse në realitet janë vetëm një virus, ose të paktën shumë viruse të ngjashme.

Metastaza e sarkomës së Kaposit, me të cilën është përfshirë e tërë dora e djathtë

Mirëpo zbulimi i virusit që shkakton këtë sumndje, nuk mjafton për t'u konstatuar se ai virus është i vetmi shkaktar i sëmundjes së përmendur. Na është e njohur nga shkenca mbi mikrobet dhe parazitët, se ekzistimi i virusit, i bakterit ose i parazitit të caktuar në trupin e njeriut nuk është dëshmi e sëmundjes.

Ka shumë persona që e bartin virusin ose bakterin, por nuk sëmuren, ndërsa ka persona që sëmuren, por është shumë vështirë të zbulohet virusi që ka shkaktuar sëmundjen.

Fillimi i sëmundjes është pra i kushtëzuar edhe nga faktorë të tjerë shumë të rëndësishëm. Faktorët përcjellës të paraqitjes së sëmundjes së sida-s janë:

1. Sperma e të shfrenuarve seksualë, e cila e dobëson imunitetin dhe automatikisht e lehtëson përhapjen e këtij mikrobi;
2. Shfrenimi seksual dhe përdorimi i drogës përhapin një grup mikrobesh që e dobëson mekanizmin mbrojtës. Një prej tyre është

virusi Epshtajn-Bar dhe Citomegalovirusi.

3. Përdorimi i barnave të nitrarit, veçanërisht thithja e amil-nitrarit, të cilin e përdorin të shfrenuarit seksualë për ta zgjatur forcën e ndikimit seksual. Është konstatuar se kjo lëndë ndikon në zvogëlimin e imunitetit;

4. Gatishmëria trashëguese për pranimin e sëmundjes, dhe pamundësia e mbrojtjes ose e luftës kundër saj;

5. Është konstatuar se prostitutat, si pasojë e kontakteve të shumta seksuale me persona të ndryshëm, kanë imunitet të zvogëluar, posaçërisht kur janë në pyetje organet gjenitale;

Sistemi mbrojtës dhe gjendja e tij me rastin e sëmurjes nga SIDA

Sida është sëmundje me rastin e së cilës humbet imuniteti. Për ta kuptuar këtë fjali, duhet të jemi të vetëdijshëm se Allahu ﷻ organizmit të njeriut (dhe qenieve të tjera të gjalla) i dhuroi mjete efikase mbrojtëse, të cilat e mbrojnë nga telashet e “armiqve” të tij dhe i përgjigjen “kompleteve të mashtruesve” dhe sulmeve të “sulumuesve zullumqarë”.

Këto mjete përbëhen nga:

- Rruazat e bardha të gjakut; ka shumë lloje rruazash të bardha gjaku, e ato që janë të detyruara për luftë kundër sulmuesit janë të njohura me emrin limfocite, të cilat ndodhen në gjak, në gjëndra, në mëlqi, në shpretkë dhe në palcën kurrizore.

Rrugët e përhapjes së SIDA-s

Folëm për grupet e të sëmurëve nga sida, kjo ndarje dëften edhe rrugët e përhapjes së saj, e që mund të reduktohen në këto:

1 - Marrëdhëniet seksuale: Nëse personi bart virusin e sida-s, marrëdhëniet seksuale, edhe nëse ato janë marrëdhënie të ligjshme ndërmjet çiftit bashkëshortor ligjor, sjellin deri te sëmurja e partnerit të tij. Për shkak se virusi, para së gjithash, përhapet nëpërmjet spermës.

Nëse bëhet fjalë për personin të quajtur biseksual, d.m.th. i cili merret me seks të shfrenuar, por njëkohësisht edhe me formën normale të seksit, virusi të cilin ai e bart nuk do të kalojë vetëm tek ata që praktikojnë seks të shfrenuar, por do të kalojë edhe tek personat e gjinisë së kundërt me të cilët ai ka marrëdhënie.

Statistikat tregojnë se 70-74 % e të sëmurëve nga sida, në SHBA dhe në Evropë, i përket të shfrenuarve seksualë.

Në Zaire, në Republikën e Afrikës së Mesme, në Ruandë, në Burundi, në Keni dhe në Zimbabve (i ashtuquajtur brezi afrikan) shfaqja e sida-s është e lidhur me prostitucionin, mandej me meshkujt, me gratë dhe me fëmijët.

2 – Mbarsja artificiale: Meqenëse sperma përmban viruset që e përhapin sida-n, shpesh mbarsja artificiale bëhet shkaktar i sëmurjes së gruas që pranon spermë të tillë. Në Australi kanë ndodhur katër raste të tilla (Esh-Sherkul-evsat, 26/7/1985);

3 - Injeksionet e infektuara, të cilat jepen në venë; është e njohur se narkomanët kronikë, sidomos ata që përdorin heroinën e morfiumin, për këtë qëllim përdorin injeksione që i marrin drejt në venë, ndërsa e dimë se virusi i sida-s ndodhet në gjak, kështu sida në këtë mënyrë përhapet në mesin e narkomanëve.

Është konstatuar se 17% nga rastet e përgjithshme të sida-s në Amerikë dhe në Evropë janë narkomanë.

Ky rrezik ekziston edhe në vendet e botës së tretë, sepse një injeksion përdoret për shumë të sëmurë, pa dezinfektim të nevojshëm. Prandaj sëmundja mund të bartet përmes injeksioneve që jepen në venë, ose pa dije, përmes injeksioneve që jepen në muskuj, nëse nuk janë mjaft të dezinfektuara.

Pasi shumë vende të varfra në Afrikë dhe në Azi nuk janë në gjendje të sigurojnë injeksione të mjaftueshme për një përdorim (Disposable Syringes), institucionet shëndetësore të atyre vendeve janë të obliguara të vendosin masa preventive (të rrepta) të kontrollit të dezinfektimit të injeksioneve dhe të instrumenteve të tjera mjekësore, ngase kështu mund të infektohen miliona njerëz;

4 - Transfuzioni i gjakut ose i përbërësve të tij: E dimë se virusi që shkakton sëmundjen e sida-s qëndron në gjak. Duke qenë se një mililitër gjak e të sëmurit nga sida përmban përafërsisht 100000 njësi të viruseve aktive, bartja e gjakut ose e përbërësve të tij sjell deri te bartja e sëmundjes nga i sëmuri në të shëndoshin.

Është konstatuar se i sëmuri nga hemofilia shumë lehtë mund të sëmuret nga sida.

Bartja e gjakut konsiderohet ndër shkaktarët e sëmurjes nga sida tek 2-4% nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve në Amerikë dhe në Evropë.

Në Arabinë Saudite janë shfaqur dy raste të sida-s, për shkak të transfuzionit të gjakut të importuar nga SHBA-të.

Konsiderohet se ky shkak në tërësi do të zhduket në të ardhmën e afërme, ngase faktori 8, i cili u jepet të sëmurve nga hemofilia, i nënshtrohet temperaturës 60 gradë, që është e mjaftueshme për t'u shkatërruar ai virus.

Po ashtu, qendrat për grumbullimin e gjakut kryejnë analiza me të cilat zbulohet ekzistimi i trupave mbrojtës kundër virusit të sida-s dhe nëse konstatohet ekzistimi i tyre në gjak, ai gjak largohet nga përdorimi.

Ekziston mundësia e sëmurjes së doktorëve dhe të punëtorëve nga sida nëpër laboratore në të cilat punohet me gjakun e të sëmurëve të infektuar nga sida;

5 - Fëmijët e të sëmurëve nga sida, ose e të atyre që bartin

virusin që shkakton sëmundjen. Virusi bartet nga njëri prej prindërve tek fëmija, në disa mënyra:

- a) Sperma përmban virusë të sida-s. Gjatë fekondimit të vezës nga spermatozoidi, virusi hyn në vezë dhe mund të shkaktojë abortim;
- b) Virusi kalon nga gjaku i nënës në gjakun e shtratit të embrionit (placentës);
- c) Fëmija sëmurët me rastin e lindjes dhe të daljes nga mitra nëpërmjet vagjinës;
- d) Sëmurja mund të ndodhë pas lindjes, përmes gjidhënies;
- e) Sëmurja ndodh për shkak të lidhjes shumë të afërt mes fëmijës dhe prindërve të tij.

6 - Sekretimi i pështymës dhe i lotëve: Pështyma dhe lotët përmbajnë virusin e sida-s, i cili në këtë mënyrë mund të kalojë nga personi i infektuar tek të tjerët;

7 - Ekziston mundësia e sëmurjes përmjet pështymës dhe përmjet kollitjes;

8 - Ekziston mundësia e sëmurjes përmes lëngut të njohur me emrin “likuori cerebrospinal”. Kjo ka të bëjë me mjekët, me inxhinierët dhe me punëtorët në laboratore, të cilët punojnë në analizat e lëngjeve të tilla;

9 - Ekziston mundësia e përhapjes së sëmundjes përmes urinës dhe fekaleve. Është fat i madh që ende nuk është shënuar rasti i bartjes së sida-s në këtë mënyrë. Laboraret deri tani nuk kanë arritur të ndajnë virusin përkatës nga urina dhe nga fekalet.

Nuk habit ekzistimi i këtij virusi në këto sekrete, sepse virusi gjendet në të gjitha sekretet trupore, sikurse që janë: sperma, pështyma, likuori cerebrospinal, lotët, si dhe gjaku dhe plazma;

10 - Mundësia e infektimit të atyre që punojnë me të sëmurët nga sida. Kjo veçanërisht ka të bëjë me mjekët, me infermierët dhe me punëtorët nëpër spitale. Kjo zakonisht ndodh përmes gërvishjes, përmes injeksioneve të infektuara, përmes gjakut ose përmes sekreteve që në vete përmbajnë virusin e sida-s.

Kanë ndodhur disa raste të sëmurjes nga sida tek punëtorët në spitale dhe te infermierët.

Simptomet e sëmundjes së SIDA-s

1. Rritja e gjëndrave limfatike në të dy anët e trupit;
2. Humbja e më tepër se 10% të peshës, në periudhë dymuajshe;
3. Ethe të vazhdueshme, me djersitje të përhershme gjatë natës, të cilat zgjasin disa muaj;
4. Inflamacioni i mushkërive, me frymëmarrje të vështirësuar dhe me kollitje, i cili zakonisht shkaktohet nga paraziti *Pneumocystis Carini*;
5. Sëmuri e lëkurës, e cila pasqyrohet me pika të thelluara, të cilat i ngjajnë puçrrave të mavijosura, kudo nëpër trup dhe me sëmundje kërpudhore ose me infeksione bakteriale në lëkurë;
6. Kanali i tretjes: kërpudhat e Kandidit në gojë, në gjuhë, në laring dhe në ezofag. Diarreja e shkaktuar nga viruset, siç janë Cytomegalovirusi, ose nga kërpudhat, siç janë: *Cryptosporodiasis*;
7. Sistemi nervor: i sëmuri bëhet i papërgjegjshëm dhe i dëshpëruar dhe pastaj në fund e përfshin çmenduria. Lajmërohen edhe simptome të tjera, sikur që janë inflamacioni i mbështjellësit të trurit, që shkakton lloje të ndryshme të paralizës me kokëdhembje të madhe, e ndodh që i sëmuri të verbohët gjithashtu.

Ajo që edhe më shumë ndikon në vështirësimin e gjendjes, është fakti që i sëmuri nga sida e di se nuk ekziston shërimi (ilaçi) dhe vëren se si të gjithë i largohen, madje edhe familja më e afërt e tij dhe prindërit. Të gjithë ata i frikohen infektimit. Hidhërimi i tij bëhet edhe më i madh kur e di që ndoshta askush nuk do të dëshirojë ta mbështjellë atë me qefin kur të vdesë. Ndoshta ndjenja e frikës dhe përbuzja ndaj tij do të vërehet edhe në shikimin e vet doktorëve dhe të infermierëve. Kështu, së paku, ndihen disa të sëmurë nga sida, që vetë e kishin deklaruar këtë.

Rrallëherë ndodh t'i vizitojë ndokush, përveçse shokët e tyre që kanë qenë bashkëpjesëmarrës në ato shfrenime. Kjo shkakton frikë

të madhe edhe te partnerët e tyre, kur e shohin përfundimin tragjik që edhe ata i pret.

Zgjatja mesatare e jetës

Zgjatja mesatare e jetës pas shfaqjes së tumorit malinj "SARKOMA" tek të sëmurët nga sida është 16 muaj. Përderisa zgjatja mesatare e jetës pas paraqitjes së sëmundjeve parazitare në mushkëri nuk është më shumë se 8 muaj. Ekzistojnë raste të rralla, në të cilat ndodh që i sëmuri nga sida të jetojë më tepër se 2 vjet, mirëpo nuk dihet për ndonjë të sëmurë nga sida që ka jetuar më gjatë se 3 vjet. Kjo do të thotë se sida është vdekjeprurëse, më së largu në periudhën prej tri vitesh pas shfaqjes së simptomave të saj, në 100% të rasteve. Kjo është arsyeja pse frika nga kjo sëmundje sjellë deri te shkalla e histerisë.

Shërimi i SIDA-s

Deri më tani nuk është gjetur bari i suksesshëm kundër sida-s. Kjo nuk do të thotë se mjekët, së shpejti apo në të ardhmen, nuk do ta zbulojnë barin për këtë sëmundje të rrezikshme, e cila nga shfaqja e simptomeve të saj për dy-tre vjet sjellë vdekje. Përqindja e rasteve të vdekjes nga kjo sëmundje është 100%.

Pastaj harxhimet e kujdesit ndaj një të sëmuri në SHBA sillen prej 50000 deri në 150000 dollarë. Këto janë harxhime të mëdha për shtetin (1700 milionë deri në fund të 1985-tës). Krahas kësaj, mund t'i shtojmë 100 milionë që shpenzohen në hulumtimet mjekësore të lidhura me sida-n (qeveria amerikane ka caktuar vlerën prej 200 milionë dollarë për hulumtimet të lidhura me sida-n) dhe me mija milionë që kanë humbur në formë të orëve të humbura të punës për shkak të kësaj sëmundjeje të tmerrshme.

Shërimi i të sëmurëve nga sida mund të ndahet në këtë mënyrë;

1. Shërimi i sëmundjeve parazitare;
2. Shërimi i tumoreve malinje të sarkomës;
3. Shërimi i faktorëve themelorë të dobësimit të imunitetit;
4. Përpjekja e shërimit dhe lufta kundër virusit të sida-s HTLV III;

Shërimi i vërtetë (Mbrojtja para sëmundjes)

Shërimi i vërtetë i sida-s nuk janë substancat kimike, e as zbulimi i vaksinës kundër virusit të sida-s edhe pse ideja për vaksinim është ende aktuale. Pasi virusi i sida-s, sikurse virusi i rrufës, i ndryshon antigenet që i përmban në vete, është vështirë të zbulohet një lloj i ri i vaksinës për antigjene të ndryshme që vazhdimisht ndërrohen.

Para së gjithash bari i vërtetë është në kthimin e pastërtisë dhe të dëlirësisë, si dhe në largimin nga korrupsioni dhe nga droga. Nëse e dimë se 90-95% e rasteve të sida-s në SHBA-të dhe në Evropë janë të lidhura për amoralitetin (70-74% seksi i shfrenuar, 17-20% droga, dhe 2-3% prostitucioni), e shumica e këtyre rasteve në Afrikë janë të lidhura për prostitucionin, atëherë bari i vërtetë është në largimin nga gjërat që vijnë:

- 1 – Nga seksi i shfrenuar;
- 2 – Nga droga;
- 3 – Nga zinaja (prostitucioni).

Do të thotë, bari nuk është në tableta dhe në substanca kimike, e as në rrezatim e në vaksinim, sepse pengimtar në shërimin e sëmundjeve veneriane është morali njerëzor.

Për fat të keq, ne jemi duke parë se si mjekët, mjeket dhe mjetet për informim në përfundim i shmangen thirrjes në pastërti dhe në dëlirësi dhe këshillat e veta i drejtojnë në mënyrë vijuese:

- 1 - Nëse je prej atyre që merren me seks të shfrenuar, atëherë zgjidhe vetëm një partner, në vend që të bësh seks me secilin që takon;
- 2 - Nëse je prej atyre që përdorin drogën, provo të përdorësh vetëm shiringa të dezinfektuara dhe të papërdorura më parë dhe secilën shiringë ta hedhësh menjëherë pas përdorimit;

3 - Nëse je prej atyre që bëjnë zina, duhet ta zgjedhësh vetëm një dashnore. Këshilla e njëjtë vlen edhe për personin femëror, ajo duhet të zgjedhë vetëm një dashnor.

Shih sa këshilla të ulëta dhe të pavlera. Ato janë argument i dukshëm i dekadencës morale në të cilën janë kredhur perëndimorët.

Madje edhe nëse do të kishin sukses në zbulimin e barit adekuat për sida-n, kjo assesi nuk do të thoshte se me këtë do t'i vinte fundi kësaj sëmundjeje të rrezikshme. Përkundër zbulimit të barit për sifilizin, për gonorrenë dhe për klamidian, këto sëmundje janë në rritje të tmerrshme. Numri i të sëmurëve nga sifilizi rritet për 50 milionë çdo vit, numri i të sëmurëve nga gonorreja është 250 milionë në vit, kurse numri i të sëmurëve nga klamidia është 300 milionë në vit. Në SHBA-të numri i të sëmurëve nga herpesi është mbi 20 milionë dhe për çdo vit numri i të sëmurëve shtohet për gjysëm milioni.

E gjithë kjo rrjedh përkundër sasisë së mjaftueshme të barnave për këto sëmundje dhe përdorimit të thjeshtë të tyre. Miliona njerëz vuajnë nga kjo sëmundje.

Të gjitha këto janë vërtetim i fjalëve të të Dërguarit ﷺ, në të cilat thotë: ***“Kur në një popull shfaqet zinaja dhe përhapet deri në atë masë, sa që të bëhet baptazi, në të do të shfaqet murtaja dhe sëmundjet të cilat nuk kanë ekzistuar në mesin e paraardhësve që jetuan para tyre.”*** (Transmeton: Hakimi, Ibn Maxhe dhe El-Bezzari)

Në hadithin tjetër qëndron: ***“Kur në një vendbanim të caktuar shfaqet zinaja dhe kamata, atëherë banorët e tij e kanë merituar dënimin e All-llabut ﷻ.”*** (Transmeton: El-Hakimi nga Ibn Abbasi dhe thotë që hadithi është sahih).

Dënimet e kësaj bote, edhe përkrah peshës dhe tmerreve të tyre, janë të parëndësishme kundruall dënimeve të ahiretit (të botës së ardhme), të cilat janë më të rrepta dhe më të tmerrshme.

Format e tjera të mbrojtjes nga sëmundja e sida-s

Duke qenë se sida mund të bartet përmes transfuzionit të gjakut ose nëpërmjet përbërësve të tij, është e nevojshme të merren këto masa mbrojtëse:

1. Mosimportimi i gjakut nga vendet në të cilat është e përhapur sida;
2. Analizat e gjakut, të cilat kryhen për t'u konstatuar ekzistimi i trupave mbrojtës nga virusi HTLV III. Nëse analizat tregojnë se në atë gjak ekzistojnë trupat mbrojtës nga ai virus, arëherë njeriut përkatës do t'i ndalohet dhënia e gjakut të vet, apo dhënia e cilësdo pjese të trupit të vet (Këto janë raste të rralla në vendet islame).
3. Analizat e sasisë ekzistuese të gjakut, të plazmës së gjakut dhe të përbërësve të tjerë të gjakut, për t'u konstatuar trupat mbrojtës nga virusi HTLV III;
4. Të gjithë ata që kanë qenë në kontakt me të sëmurin nga sida (të sëmurët nga hemofilia, narkomanët dhe ata që janë të sëmurë nga sifilizi) janë të obliguar të ndërpresin dhënien e gjakut;
5. Të sëmurët nga hemofilia, të cilëve u nevojitet faktori 8, para përdorimit të tij duhet të konstatojnë se a i është ekspozuar ky faktor temperaturës prej 68 gradë në zgjatje kohore 24-orëshe. Është e njohur se me nxehjen e faktorit 8 në këtë temperaturë dhe në atë kohëzgjatje, virusi që shkakton sida-n shkatërrohet.

Duke qenë se në shumicën e vendeve të botës sot bëhen analizat e gjakut, faktori 8 i cili mblidhet nga ai gjak, do të duhej të ishte i pastër nga virusi i sida-s.

Arabia Saudite ka futur masa të reja preventive, kështu, ata që vijnë nga vendet të prekura nga virusi i sida-s, duhet të posedojnë argument profesional, nëpërmjet analizave të gjakut, se nuk janë të molepsur nga virusi i sida-s. Qeveria Saudite ka kërkuar nga ambasadat e veta që mos t'u japin vizë të huajve që vijnë nga Londra, nga Tajlanda, nga Amerika, vetëm pasi të vërtetohet se gjaku i tyre nuk përmban virusin e sida-s.

6. Kufizimi i vizitave turistike, sidomos në vendet të prekura me sida-n, sikurse që është Nju Jorku, San Franciskoja, Los Anxhelosi dhe metropolet e tjera të Perëndimit;

7. Shmangia nga klubet për argëtim, për masazh dhe të ngjashme;
8. Largimi nga punëtoritë në të cilat përdoret alkooli dhe nga vendet në të cilat tubohen narkomanët;
9. Shmangia nga të shfrenuarit seksualë dhe nga vendet ku ata tubohen;
10. Shmangia nga vendet e korruptuara, të cilat shpesh reklamohen si shoqëri të artit dhe të dëfrimit;
11. Të lahen duart mirë pas çdo kontakti me cilindo person, për sjelljen e të cilit ka dyshime, e veçanërisht nëse dihet se ai është i shfrenuar seksualisht, ose është duke konsumuar drogë.

Masat mbrojtëse dhe kujdesi që duhet të ketë familja e të sëmurit nga SIDA ose bartësit të virusit të SIDA-S

Masat janë këto:

1. Bashkëshortja duhet t'i ndërpresë marrëdhëniet seksuale me burrin e vet të sëmurë nga sida. Jo vetëm kaq, por nëse konstatohet se burri i saj është bartës i trupave mbrojtës nga sida, pa qenë ende i sëmurë, atëherë bashkëshortja do t'i ndërpresë marrëdhëniet seksuale me të.

Kjo pa dyshim është vështirë të zbatohet, ngase ekzistojnë miliona njerëz në botë për të cilët mendohet se në vete bartin trupat për mbrojtjen nga virusi i sida-s;

2. Mospërdorimi i brushës së huaj për dhëmbë;

3. Mospërdorimi i veglave të huaja për rroje dhe i peshqirëve të përbashkët. Kjo duhet të pranohet në përgjithësi dhe të jetë gjë normale për të gjithë njerëzit;

4. Vënia e dorëzave dhe e maskave mbrojtëse gjatë kujdesit të të sëmurit dhe gjatë ndërrimit të rrobave dhe të çarçafëve tij.

Masat mbrojtëse dhe kujdesi, që duhet të kenë mjekët dhe infermierët, që kujdesen për të sëmurët nga SIDA

Këto masa janë siç vijojnë:

1. Meqë virusi i sida-s kalon në personin tjetër nëpërmjet gjakut dhe përmes shpuarjes me gjilpërë të infektuar, ata që punojnë në laboratore dhe që marrin gjak nga të sëmurit janë të obliguar të mbrohen dhe të kujdesen nga përdorimi joprofesional i gjilpërave. Po ashtu janë të obliguar për t'u kujdesur që ndonjë pikë e gjakut të mos bjerë në trupin ose në duart e tyre. Prandaj duhet pasur kujdes të jashtëzakonshëm gjatë marrjes së mostrave të gjakut dhe këto mostra të vihen në epruveta plastike dhe të konstatohet se nuk janë të infektuara. Gjatë kësaj është e domosdoshme vënja e dorëzave të gomës;
2. Stomatologët janë të obliguar gjatë shërimit të dhëmbit të ndonjë personi për të cilin dyshohet se mund të jetë i sëmurë nga sida, t'i vënë syzet, maskën mbrojtëse dhe dorëzat.
3. Mjekët dhe infermierët janë të detyruar t'i vënë syzet, maskën mbrojtëse dhe dorëzat gjatë secilit intervenim më të vogël kirurgjik tek të sëmurët nga sida, ose tek ata për të cilët dyshohet se bartin virusin e sida-s;
4. Përdorimi i dorëzave, i maskave mbrojtëse dhe i syzeve gjatë kontrollimit të të sëmurëve nga sida, gjatë ndërrimit të rrobave dhe të çarçafëve të tyre, gjatë marrjes së mostrës së urinës së tij, të fekaleve, të gjakut ose të çfarëdo mostre, me qëllim të analizës së tyre ose për shërim të të sëmurit.

Inflamacioni venerian i kanaleve urinare (Klamidia N.G.U.)

Inflamacioni venerian i kanaleve urinare (pa gonorrenë) konsiderohet një prej sëmundjeve më të përhapura veneriane në shumicën e vendeve të botës. Dr. Villkoks, në artikullin e vet të botuar në revistën “Medicine Digest” (4/1986), konstaton se numri i të sëmurëve në Angli në vitin 1978 nga inflamacioni venerian i kanaleve urinare ka qenë dyfish më i madh se i të sëmurëve nga gonorreja. Numri i të sëmurëve nga inflamacioni i kanaleve urinare në atë vit, ka arritur në 77876 në mesin e djemve të moshës madhore, e numri i të sëmurëve nga gonorreja ka arritur në 35109.

Numri i të sëmurëve nga inflamacioni venerian i kanaleve urinare në Amerikë, ka arritur në 6 milionë në vit, ndërsa numri i të sëmurëve nga gonorreja ka arritur në 3 milionë në vit (“The Principals and Practice of Infectious Diseases”, 1979, Mandell, Daugllas+Benne).

Në vendet skandinave është konstatuar se 5-10% e vajzave që vizitojnë ordinancat për planifikim familjar, mosha e të cilave nuk i kalon të njëzetat, kanë Klamidian, që është shkaktare e inflamacionit venerian të kanaleve të urinës (Kongresi Skandinav mbi Klamidian, viti 1981).

Në shumicën e ordinancave për sëmundjet gjenitale është konstatuar se 26% të rasteve posedojnë mikrobin Klamidia (Sëmundjet veneriane - shqyrtuar në kongresin e mbajtur në Londër më 22-23/6/1975).

Gonorreja (Blenorreja) - Përhapja e gonorresë (Gonorrhoea)

Gonorreja konsiderohet si sëmundja veneriane më e përhapur në botë. Numri i të sëmurëve në vit është 250 milionë, sipas të dhënave të Organizatës Botërore për Shëndetësi (WHO) në vitin 1975. Gonorreja është në majë të listës së sëmundjeve veneriane në shumicën e vendeve të botës së tretë. Para saj është vetëm sëmundja e inflamacionit venerian të kanaleve urinare (N-G-D), të cilën nuk e shkakton gonorreja, por e shkakton klamidia.

Në vendet e Perëndimit (Europë, SHBA) gonorreja zë vendin e dytë, pas inflamacionit venerian të kanaleve urinare pa gonorrenë.

Në librin *Principals and Practice of Infectious Diseases*, që u botua në vitin 1979 qëndron: “Numri i të sëmurëve nga gonorreja kalon shifrën prej 3 milionë në vit. Të njëjtin numër e përmend doracaku mjekësor Merk, i botuar nga qendra për luftë kundër sëmundjeve infektive, në Atlanta të Xheorxhisë.

Duke qenë se evidentimi i të sëmurëve nga sëmundjet veneriane nuk është preciz, madje as në Amerikë dhe në Europë, mendohet se në institucionet zyrtare në Amerikë evidentohen vetëm 3 nga 10 rastet e të sëmurëve nga gonorreja. Për arsye se shërimi nga kjo sëmundje zakonisht bëhet nëpër ordinanca private, siç pohon dr. Villkoks, në revistën mjekësore për Amerikën Veriore (*Medical Clinics of N. Amerika*, 1972, 5. 6)

**Inflamacioni qelbëzor i syrit, te i posalinduri, për
shkak të gonorresë**

Grupet, të cilat më së tepërmi u janë të ekspozuara sëmundjes së Gonorrës dhe sëmundjeve tjera veneriane

Të shfrenuarit seksualë: Hulumtimet kanë treguar se të shfrenuarit seksualë, numri i të cilëve në SHBA momentalisht është 18 milionë, janë më së tepërmi të molepsur nga sëmundjet veneriane, edhe pse liria seksuale ka marrë hov tek të gjithë, si te meshkujt, ashtu edhe tek femrat. Edhe përkundër kësaj, ky është grupi më i ekspozuar ndaj sëmundjeve veneriane.

Sepse ata, siç thekson dr. FevXH, “nuk kënaqen të kryejnë marrëdhënie seksuale me numër të kufizuar shokësh, por këtë orvaten ta bëjnë me secilin që e takojnë. Kështu, mesatarja e atyre me të cilët kanë marrëdhënie seksuale gjatë një viti arrin 60 persona.” “Time” (numri 4/6/1983), në komentin e vet mbi fjalët e tij thotë: “Te këta njerëz seksi është përshëndetje, pas së cilës mandej pason përshëndetja e zakonshme dhe biseda.”

Gonorreja është prezente tek të shfrenuarit seksualë 270% më shumë sesa te populli i zakonshëm amerikan (Referati i dr. Villkoksit, i prezentuar në kongresin për sëmundjet veneriane, i mbajtur në Londër, në qershor të vitit 1975).

Të shfrenuarit seksualë janë grupi me përqindje më të lartë të të sëmurëve nga sida, e cila për herë të parë u shfaq në SHBA, në vitin 1979. Ata përbëjnë 72% nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve nga kjo sëmundje e tmerrshme vdekjeprurëse.

Ata në 50% të rasteve janë burim i të sëmurëve nga sifilizi në SHBA, banorët e të cilit numërojnë më se 250 milionë.

Forcat e armatosura: Hulumtimet të cilat u janë shpallur ushtrisë

amerikane në vitin 1972, e të cilat i ka publikuar dr. Villkoks në referatin e vet mbi sëmundjet veneriane, të paraqitur para kongresit të mbajtur në Londër, më 22-27 qershor të vitit 1975, tregojnë këtë:

- 40 prej çdo 1000 ushtarëve në SHBA janë të infektuar me gonorre.

- 641 prej çdo 1000 ushtarëve amerikanë në Tajlandë janë të infektuar me gonorre.

- 700 prej çdo 1000 ushtarëve amerikan në Kore, janë të infektuar me gonorre.

në Vietnam kjo shifër arrin 739,6 prej çdo 1000 ushtarëve, domethënë 74% prej numrit të përgjithshëm të ushtarëve amerikanë, të cilët gjendeshin në Vietnam më 1972.

- në vitin 1972 në Vietnam, për çdo javë mesatarisht nga gonorreja janë sëmurë 40000 ushtarë.

Prostitutat: Prostitutat janë me përqindje grupi më i goditur nga sëmundjet veneriane, e veçanërisht nga gonorreja, në të gjitha vendet e botës.

Në Britani prostitucioni zyrtarisht është ndaluar në vitin 1959, madje në SHBA-të dhe në shumë vende të tjera të botës, megjithatë prostitucioni në të ka mbetur jozyrtarisht. Ekzistojnë shumë vende të cilat zyrtarisht e lejojnë prostitucionin dhe ai kryhet nën mbikëqyrjen e qeverisë së tyre. Këto vende janë të shumta dhe gjenden në të gjashtë kontinentet. Në Evropë është Franca, Italia, Austria. Në Azi veçohen: Tajlanda, Filipinet dhe India. I njëjti rast është edhe me shumë vende të Amerikës Latine, të Afrikës së Mesme dhe të vendeve të bashkuara të botës Islame, sikurse që janë Turqia, Tunisi, Algjeria, Marokoja, Irani (gjatë kohës së Shahut), Pakistani (deri të sundimi Buto), Siria, Libani dhe Indonezia.

Është konstatuar se 90-100% e prostitutave janë të infektuara me sëmundjet veneriane, e veçanërisht me gonorrenë. Kjo është konstatuar zyrtarisht në vendet që vijnë: në Francë, në Portugali, në Austri, në Irak, në Egjipt, në Turqi, në Indi, në Tajlandë, në Malejzi. Këto i paraqet dr. Villkoks në referatin e cekur.

Studentët dhe rinia: Studimet e bëra në SHBA në vitin 1972 tregojnë se rinia ndërmjet moshës 15 dhe 19-vjeçe , i është

ekspozuar kësaj sëmundjeje 3 herë më shumë sesa kategoritë e tjera të shoqërisë, edhe pse vitet më të rrezikshme të kësaj sëmundjeje janë ndërmjet moshës 20-24, kur ajo përqindje rritet deri në 6 % më tepër sesa në kategoritë e tjera të shoqërisë.

Nga disa studime të publikuara nga Villkoks, Aria Vebint dhe Gollen, shihet qartë se 25-30% e studentëve në universitetet e perëndimit, janë të infektuar me gonorrenë gjatë tërë vitit.

Studentët dhe rinia zhyten në aventura të shumta gjatë udhëtimeve (studimet e Sblutit, në vitin 1976), ndonëse mendohet se studentët e fakultetit janë shtresa më e shkolluar e një shoqërie dhe se ata shumë mirë dinë për rrezikun e sëmundjeve veneriane.

Megjithatë, epshet seksuale, shmangia nga martesë, shfrenimi i përgjithshëm dhe humbja e vlerave të moralit, të fesë, të principeve fetare ka sjellë deri te përqindja e madhe e këtyre sëmundjeve në mesin e të rinjëve, që gati arrin përqindjen e të sëmurëve tek prostitutat dhe te ushtarët.

Dr. Villkoks konsideron se një nga shkaqet e përhapjes së gonorresë dhe të sëmundjeve të tjera veneriane është dalja e gruas në vendet e punës, apelet për lirinë e saj seksuale, shkollimi i përzier (djem e vajza) në shkolla dhe në universitete, punësimi i njerëzve jashtë atdheut pa familjet e tyre, tregtia e organizuar botërore me seks, përhapja e alkoolit dhe e drogës, turizmi, industrializimi, krijimi i metropoleve, mosrespektimi i jetës martesore, mungesa e dëshirës për lidhjet martesore dhe humbja e moralit dhe e ndërgjegjes fetare.

Sifilizi

“Bota ishte dëshmitare e madhe e valëve të mëdha të përhapjes së sifilizit, kur ai për herë të parë u shfaq në vitin 1494 gjatë luftës italo-franceze, atëherë kur zinaja u përhap në mesin e ushtarëve dhe me atë rast ky u bë shkak i shfaqjes së sifilizit. Francezët e quajtën sëmundje italiane, kurse italianët e quajtën sëmundje franceze. Kjo sëmundje ishte shkak i vdekjes së dhjetëra miliona njerëzve, kurse jeta e qindra miliona njerëzve të tjerë u shndërrua në vuajtje të padurueshme gjatë pesë shekujve të kaluar.”

(King, Nikol dhe Rodez, në librin e tyre “Sëmundjet veneriane”, botuar më 1980, si dhe Robert Nobel në librin e tij “Sëmundjet veneriane”, botuar më 1979).

Përhapja e Sifilizit

Sifilizi në përgjithësi konsiderohet si sëmundja më e rrezikshme veneriane, përveç sëmundjes së sida-s, e cila është shfaqur më herët dhe e cila me rrezikun e vet i ka tejkaluar të gjitha supozimet. Nga numri i përgjithshëm i të sëmurëve nga sida, që kur u shfaq në vitin 1979 deri sot, 60% përfunduan me vdekje.

Në vitin 1943, kur u zbulua penicilina, dukej se sifilizi do të zvogëlohej dukshëm dhe mjekët e shumtë e prognozonin zhdukjen e tij të tërësishme.

Megjithatë përkundër zvogëlimit të numrit të të sëmurëve nga sifilizi në botë, e sidomos në Perëndim në 50 vitet e fundit të këtij shekulli, raportet e organizatave botërore të shëndetësisë tregojnë se numri i të sëmurëve nga sifilizi në vitin 1975 është 50 milionë, siç paraqet doracaku mjekësor Mark.

Ky me të vërtetë është numër shumë i madh!!

Atlanta, qendra për luftë kundër sëmundjeve ngjitëse, konsideron se numri i të sëmurëve nga sifilizi në SHBA ka arritur në 400000,

në vitin 1976.

Dr. Riçard Robert në referatin e vet të punuar për kongresin mbi sëmundjet veneriane, të mbajtur në Londër më 22-25 qërshor të vitit 1975 thotë: “SHBA-të në vitin 1974 kanë bërë analiza të serumit përkitazi me sifilizin tek 38 milionë amerikanë. Hulumtuesit kanë konstatuar se rezultatet e milionave prej tyre ishin pozitive,

Gjunjët të përfshirë nga sifilizi në fazën *Tabes dorsalis* “*Articultio charcot*”

domethënë se ata qenë të infektuar me sifilizin bile një herë gjatë jetës së tyre. Sa i përket të sëmurëve të rinj nga sifilizi në SHBA, është një rënie e dukshme në atë plan. Në vitin 1950 janë shënuar 32000 raste të reja të të sëmurëve nga sifilizi, kurse në vitin 1956 ai numër ka rënë në 5000, por mandej ky numër filloi të rritej përsëri në vitin 1974, kur ka arritur në 26000.

Meqenëse shumica e këtyre rasteve nuk evidentohen, ngase shërohen në ordinanca private, numri i përmendur shënon vetëm një pjesë të numrit real, i cili sipas vlerësimit të qendrës Atlanta për luftë kundër sëmundjeve infektive paraqet 400000.

Në vendet në zhvillim, pas përdorimit të gjerë të penicilinës gjatë viteve të dyzeta dhe të pesëdhjeta të këtij shekulli, është vërejtur po ashtu një rënie e fortë e sifilizit, por ajo rënie nuk është as e përafërt me rënien që ka ndodhur në Perëndim.

Dr. Areja në librin e vet “Sëmundjet veneriane në vendet tropikale” thotë: “Sifilizi në të gjitha stadiumet e vet është ende i përhapur në meset tropikale dhe në Azinë Lindore. Megjithatë numri i të sëmurëve ka rënë në krahasim me numrin e të sëmurëve gjatë viteve të dyzeta dhe të pesëdhjeta të këtij shekulli.

Në Angli që nga viti 1946 sifilizi ka përjetuar rënie të madhe, kur numri i të sëmurëve nga sifilizi përfshinte 18000, e mandej në vitin 1953 është zvogëluar në 1000, e në vitin 1977 ndodhi një rritje e vogël, ashtu që ky numër arriti në 1735, nga të cilët 1486 ishin meshkuj dhe 249 femra.

Me siguri lexuesi e ka vërejtur se numri i të sëmurve tek meshkujt është shumë më i madh sesa tek femrat. Për shkak se 26% i numrit të përgjithshëm të të sëmurëve nga sifilizi janë të shfrenuarit seksualë (homoseksualët). Në Angli të shfrenuarit seksualë ishin shkak në 42,4 % të rasteve të të sëmurve nga sifilizi.

Çka është sifilizi?

Sifilizi është sëmundje që në esencë përhapet nëpërmjet kontaktit seksual, ose përmes placentës nga nëna në embrion, ose përmes transfuzionit të gjakut, ose përmes kontaktit në fazat e mëvonshme. Mënyra kryesore e përhapjes së saj është marrëdhënia seksuale. Infektimi kalon nga i sëmuri në të shëndoshin, ose përmes marrëdhënieve normale bashkëshortore (të burrit me gruan), ose përmes marrëdhënieve seksuale të shfrenuara (në rektum-anus dhe të ngjashme), ose përmes puthjes në buzë (gojë) të personit të infektuar. Thuhet nuk ekziston asnjë pjesë trupi që nuk mund të molepset nga sifilizi, edhe pse infektimi zakonisht ndodh në vendet që i cekëm.

Pas marrëdhënieve seksuale, në kohën prej 10-90 ditë (mesatarisht tri javë), në vendin e caktuar lajmërohet një plagë rreptësisht e kufizuar, pa dhembje. Mund të ndodhë që kjo plagë të mos jetë e

dukshme. Ajo zakonisht është pa dhembje dhe zgjat 2-6 javë, e mandej largohet pa kurrfarë shërimi.

Kjo është e ashtuqujtur faza fillestare e sifilizit (Primary Syphilis), kurse faza e dytë lajmërohet 2-6 muaj pas humbjes së plagës së përmendur. Pas kësaj, pason faza më e rëndësishme, e cila quhet “sifilizi i vonuar”.

Mbrojtja

Më mirë është një dërmim i mbrojtjes sesa një kuintal bar, ndërsa mënyra më e mirë e mbrojtjes është shmangia nga zinaja, nga homoseksualizmi dhe nga të gjitha format e të shfrenuarit të fshehtë a të hapur.

All-llahu ﷻ thotë: “Dhe mos iu afroni amoralitetit (zinasë), sepse vërtet është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë e keqe. [El-Isra: 32]. Nuk ka dyshim se ajo është rrugë e keqe dhe fundi i tij është i mjerueshëm. Është i pashmangshëm forcimi i imanit dhe forcimi i lidhjes së zemrës me All-llahun ﷻ, gjithnjë derisa njeriu ta shohë All-llahun ﷻ në çdo situatë. Kur të jetë në atë nivel, me siguri se kurrë nuk do të bëjë amoralitet, ose ndonjë të folur të keqe, ose dëshmi të rrejshme.

Kjo është forma e parë e mbrojtjes, kurse forma e dytë e mbrojtjes është edhe martesë. Me të vërtetë natyra e njeriut anon pas shokut të vet. Allahu ﷻ thotë: ***“O ju njerëz! Kijani frikën Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një vete (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra...”*** [En-Nisa: 1] ***“...njëri prej dëshmimeve të Tij është ajo, që për ju, nga lloji juaj, krijoi gratë që të qetësoheni afër tyre...”*** [Er-Rum: 31]

Nëse ky epsh dhe shtytje, të cilin All-llahu ﷻ me arsye e krijoi, nuk drejtohet ashtu siç ka urdhëruar All-llahu ﷻ, rezultati do të jetë shkatërrues, sepse ato duhet të shprehen në mënyrë të caktuar. Nëse kjo nuk bëhet në mënyrën hallall, do të jetë me mënyrën haram. Prandaj është e domosdoshme të lehtësohet çështja e martesës dhe të ndihmohet në atë drejtim.

Kjo është forma më e rëndësishme e mbrojtjes dhe mandej pasojnë

edhe format sekondare të mrojtjes, të cilat pasqyrohen në shërimin adekuat të të sëmurit, në zbulimin e sëmundjes në kohë të duhur, para se të përhapet dhe të marrë hov, para se të sëmurët të bartin sëmundjen e tyre në të tjerët. Pasi që i sëmuri nga sifilizi sëmundjen e vet mund ta bartë në gruan e vet, e ajo në bijtë e vet, infektimi nuk kufizohet vetëm me prostitucion. Përkundrazi, i sëmuri nga sifilizi në fazën e dytë të tij, mund ta bartë infektimin përmes prekjes me çilindo person të shëndoshë. Po ashtu, të porsalindurit me sifiliz të trashëguar, mund ta bartin këtë sëmundje në personat që kanë kontakt me ekstraktet dhe me pështymën e tyre.

Pra, nëse sëmundja zbulohet dhe fillon shërimi i saj, rrethi i infektimit do të ngushtohet. Kjo konsiderohet si një prej formave shumë të rëndësishme të mbrojtjes, që plotëson të parin.

**Ithati sifiliztik në lëkurë, në fazën Tabes dorsalis
“gummatous”**

Ilaci i vërtetë është pastërtia

Për çdo sëmundje veneriane të përmendur tani ekziston bari i caktuar, ose ai është në fazë të zbulimit. Megjithatë, nuk ka dyshim se këto barna nuk sjellin deri te zgjidhja e problemit rrënjësor dhe nuk ofrojnë zgjidhje përfundimtare.

Po ashtu, këto probleme nuk mund të zgjidhen me mjete mbrojtëse, për të cilat shumica mendojnë se janë të dobishme po të përdoren, sikurse që janë përdorimi i antibiotikëve, e të ngjashme. Përkundrazi, mjekët këshillojnë shmangien e antibiotikëve.

Po ashtu, problemi nuk mund të zgjidhet me këshillat të drejtuara nga disa pedagogë dhe mjekë të Perëndimit, se si duhet kufizuar vetëm në një dashnor a dashnore.

Bari i vërtetë fshihet pas një fjale: PASTËRTIA.

Kjo fjalë e shkurtër, por fjalë me përmbajtje, e ka tregimin e vet, të cilin do të dëshiroja ta paraqisja këtu. Kur i kam lexuar anketat e tmerrshme mjekësore për përhapjen e sëmundjeve veneriane dhe të llojeve të ndryshme të seksit të shfrenuar, kjo më ka frikësuar dhe ka nxitur interesim tek unë. Posaçërisht pse ato sëmundje nuk janë prezente vetëm në mjediset e të pafeve, por ato vërehen edhe në mjediset muslimane anembanë botës, edhe pse përqindja e të sëmurëve në mjediset muslimane është shumë më e vogël sesa tek popujt e tjerë.

Një natë në ëndërr, e pashë të Dërguarin ﷺ, por nga nderimi dhe respekti nuk mund ta drejtoja shikimin kah ai dhe e pyeta: **“O i Dërguar i All-llahut, sëmundjet veneriane janë duke i shkatërruar njerëzit, cili është bari?”**

I Dërguari ﷺ atëherë më është përgjigjur me një fjalë: **“El-Ihsan”.**

Mandej u zgjova nga gjumi dhe mendova për këtë fjalë të thellë, e cila përfshin disa kuptime. Pastaj i kontrollova fjalorët dhe

konstatova se kjo fjalë ka shumë kuptime. Një prej tyre është kujdesi, mbrojtja, pastërtia, liria dhe martesë.

All-llahu ﷻ thotë:

“(Nuk ju lejohet të martoheni) Edhe me gra të martuara (që kanë burrat e nuk janë të lëshuara), përveç atyre që i keni futur në pushtetin tuaj (robëreshat e luftës). (Ky është) Obligim mbi ju nga All-llahu. Ju janë të lejuara, pos këtyre (që u përmenden), të tjerat që t’i merrni me pasurinë tuaj (me nikah), duke pasur për qëllim bashkëshortësi e jo prostitucion (kurvëri). E për atë që përjetuat ju nga ato (gratë me të cilat patët kurorë), jepjani shpërblimin e tyre të caktuar, ngase është obligim. E nuk ka pengesë për ju, pas përcaktimit (të nikahut), në atë që ju pëlqeni mes vete. All-llahu është i Gjithdijsmi, i Urti.” “Dhe kush nuk ka prej jush mundësi materiale që të martohet me femra të lira besimtare, le të martohet me ato besimtare tuajat që i keni nën pushtetin tuaj (robëreshat). All-llahu di më së miri për besimin tuaj. Ju jeni nga njëri-tjetri (të një origjine). Pra, martohuni me ato (robëresha), e me lejen e të zotërve të tyre dhe jepuani kurorën në mënyrë të drejtë, (zgjidhni) të ndershme e jo prostituta të bapta apo të fshehta. E kur të jenë të martuara ato, nëse bëjnë ndonjë punë të turpshme, ndëshkimi kundër tyre është sa gjysma e (ndëshkimit) të grave të lira (jo robëresha). Kjo (martesë me robëresha) është e lejuar për ata që i frikësohen imoralitetit, por të jeni të durueshëm është më mirë për ju. All-llahu është Mirëdashës, Mëshirplotë.” [En-Nisaë: 24-25]

“Mos i detyroni robëreshat tuaja të bëjnë amoralitet, për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra...” [En-Nur: 33]

“Edhe Merjemen të bijën e Imranit, që e ruajti nderin e vet...” [Et-Tahrim: 12]

“Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju

edhe ushqimet (të therrurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar). Gratë e ndershme besimtare dhe (gra) të ndershme nga ata të cilëve u është dhënë libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe jo (të jenë) dashnore ilegale.” [El- Maide: 5]

“Ne i mësuam atij (Davudit) mbarimin e petkave (të hekurta) për ju, që t’ju mbrojnë në rast lufte. A jeni pra mirënjohës ju për këtë.” [El-Enbija: 80]

“Pastaj do të vijnë shtatë (vjet) të vështira (me skamje) që do të hanë atë që e keni ruajtur për to, përveç një pakice nga ajo që do ta ruani (në depo për farë)” [Jusuf: 48]

“...e ata menduan se fortifikatat e tyre do t’i mbronin nga ndëshkimi i All-llahut....” [El-Hashër: 2]

“Ata të gjithë së bashku nuk kanë guxim t’ju luftojnë, vetëm kur gjenden në ndonjë vend të fortifikuar ose kur janë pas ndonjë muri...” [El-Hashër: 14]

Mjet parësor dhe më i rëndësishëm i pastërtisë (mbrojtjes-ihsanit) është islami dhe imani. Kur njeriu hyn në rrethin e imanit dhe të islamit, ai mbrohet me mbrojtjen më të madhe dhe më efikase kundër shejtanit dhe kalon nga faza e adhurimit të shejtanit në adhurimin e All-llahut.

Dhe kur imani i tij forcohet, All-llahu i dhuron atij devotshmëri, e devotshmëria (takwa) do të thotë që njeriu të ruhet nga çdo gjë që All-llahu ka ndaluar, dhe t’i shmanget hidhërimit të Tij, aq sa është në gjendje ta bëjë atë.

Kjo është fortifikatë e fortë, me të cilën mbrohet nga cytja e shejtanit dhe nga shtytja e epshit të vet. Islami dhe imani janë format primare dhe kryesore të mbrojtjes, me të cilat ai e mbron veten nga cytja e shejtanit dhe nga shtytja e epshit.

Forma sekondare e kësaj mbrojtjeje, sipas rëndësisë, është martesë. Islami përkrahje të veçantë i jep martesës dhe në shumë mënyra nxitë në të, kurse ndalon çdo formë të kënaqjes së epsheve jashtë martesës.

All-llahu ﷻ thotë: *“Dhe martoni të pamartuarat (të pamartuarit) edhe robërit e robëreshat tua që janë të ndershëm e të ndershme...”* [En-Nur: 32]

“E në qoftë se frikësoheni se nuk do të jeni të drejtë ndaj bonjakëve, atëherë martohuni me ato gra që ju pëlqejnë, me dy, tri e me katër.” [En-Nisa: 3]

“Pra, martohuni me ato (robëresha) e me lejen e të zotërve të tyre dhe jepjani kurorën në mënyrë të drejtë, (zgjidhni) të ndershme, e jo prostituta të bapta e të fshehta.” [En-Nisa: 25]

All-llahu ﷻ pas përmendjes së grave, të cilat janë të ndaluara thotë: *“...ju janë lejuar, pos këtyre (që u përmendën), e të tjerat që i merrni me pasurinë tuaj (me nikah), duke pasur për qëllim bashkëshortësinë, e jo prostitucion (amoralitet).”* [En-Nisa: 24]

I Dërguari ﷺ thotë: *“O djemë, ai i cili prej jush është në gjendje të martobet, le ta bëjë atë, sepse ashtu më lehtë do ta ruaj shikimin e vet dhe organin gjenital të tij. E ai i cili prej jush nuk është në gjendje ta bëjë këtë, le të agjërojë, sepse agjërimi është mbrojtje.”* (Transmeton: Buhariu, Muslimi, Ebu-Davudi, Tirmidhiu, Nesaiu dhe Maliku).

Në hadithin tjetër qëndron: *“Martesa është sunneti im. Kush e lë sunnetin tim, nuk na takon neve.”* (Transmeton: Buhariu dhe Muslimi)

“Nëse vajzën tuaj e kërkon ai, me fenë dhe besnikërinë e të cilit jeni të kënaqur, martojeni atë. Nëse këtë nuk e bëni, në Tokë do të shfaqet çregullim i madh dhe fesad.” (Transmeton Ebu-Davudi dhe Tirmidhiu)

“Martohuni me vajzat e dashura, me ato që lindin shumë, sepse unë në Ditën e Gjykimit do të krenohem me ju përpara popujve të tjerë.” (Transmeton Ebu-Davudi dhe Nesaiu)

“Kjo botë është kënaqësi (e shkurtër), ndërsa kënaqësia më e madhe në të është gruaja e hajrit.” (Transmeton: Muslimi dhe Nesaiu)

Nga ana tjetër, i Dërguari ﷺ e ndaloi beqarinë (celibatin). Se'ad ibn Ebu-Vekkasi, All-llahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: “Sikur i Dërguari ﷺ të mos ia kishte ndaluar Uthman ibn Maz'umit beqarinë, ne do të tredheshim.” (Transmeton: Buhariu, Muslimi, Tirmidhiu dhe Nesaiu)

I Dërguari ﷺ i kishte thënë Akkaf ibn Bishër et- Temimit, kur ky i kishte thënë që nuk është i martuar, kurse ishte i fortë dhe i pasur: *“Ti je, atëherë, njëri prej ndihmësve të shejtanit! Të kishe qenë i krishterë do të kishe qenë një nga priftërinjtë e tyre. Sunneti ynë është martesë. Më të këqinjët në mesin tuaj janë të pamartuarit. A jeni duke luajtur me shejtanin? Shejtani nuk ka armë më të fortë sesa gratë kundër njerëzve të mirë, përveçse kundër atyre që janë të martuar, ata janë larg zinasë.”* (Transmeton Ahmedi)

I Dërguari ﷺ i ka sqaruar arsyet e martesës dhe të nxitjes në të dhe ka thënë se martesë është lindje dhe shumim. Nuk ka dyshim se All-llahu ﷻ nuk e krijoi epshin seksual pa arsye, por e dha për shkak të ekzistimi të llojit njerëzor, ashtu siç e bëri shtytjen për ushqim për arsye të ekzistimit të individit, kurse ekzistimi i llojit është më i rëndësishëm sesa ekzistimi i individit.

All-llahu ﷻ thotë: *“O ju njerëz! Keni frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj, e prej atyre dyve u shtuan burra shumë e gra. Dhe keni frikë All-llahun, që me emrin e Tij përбетoheni, ruajeni farefisin, se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.”* [En-Nisa: 1]

I Dërguari ﷺ ka sqaruar se kjo botë është kënaqësi e shkurtër dhe se kënaqësia më e madhe në të është gruaja e hajrit.

All-llahu ﷻ thotë: *“Dhe nga faktet (e Madhërisë së Tij) e Tij, është që për të mirën tuaj Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe mes jush krijoi dashuri e mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”* [Er-Rrum: 21]

“Natën e agjërimit ju është lejuar afrimi te gratë tua, ato janë prehje për ju dhe ju jeni prehje për to.” [El-Bekare: 187].

I Dërguari ﷺ ka sqaruar se martesë është mënyra më efikase e ruajtjes së shikimit dhe të organit gjenital. Ka sqaruar se refuzimi i martesës me personin që e meriton atë shpie në çregullime dhe në turbullira në tokë.

Ka sqaruar se martesë mbron nga epshet e shfrenuara, dhe e topit tehun e epshit dhe të lakmisë. Prandaj All-llahu ﷻ këtë epsh nuk e krijoi që ne ta shuajmë atë, por që ta drejtojmë me rregullësi rrugës së drejtë e cila neve na përgjigjet dhe për t'u kënaqur në të, sepse kënaqësia më e madhe është gruaja e hajrit.

Islami nuk e ndalon kënaqësinë hallall. Përkundrazi, ai e shpërblen këtë. I Dërguari ﷺ ka thënë: ***“Edhe në organin seksual të ndonjërit prej jush është sadaka”***. Ata thanë: “O i Dërguar i All-llahut, a do të jetë ndonjëri prej nesh i shpërblyer ngase ka pasur marrëdhënie seksuale me gruan e vet?!” Ai u përgjigj: ***“Po çfarë mendoni sikur këtë ta bënte në mënyrë të ndaluar, a do të dënohej? Po ashtu, do të jetë i shpërblyer nëse atë e bën në mënyrë hallall.”***

All-llahu ﷻ kënaqësinë e marrëdhënieve seksuale e bëri si tregues të marrëdhënieve seksuale në Xhennet, që njeriu këtë ta dëshirojë dhe vazhdimisht të bëjë vepra të mira për t'i arritur ato. Këto i sqaron Gazaliu në librin e tij të njohur “El-Ihja”, në kapitullin për martesën, me fjalët: “Është ndryshim i madh mes kënaqësisë kalimtare dhe të paplotë të kësaj dunjaje dhe kënaqësisë së vazhdueshme dhe të plotë të Ahiretit.” Dobitë e martesës dhe të krijimit të familjes nuk mund të numërohen, por vetëm shkurtimisht mund të tregojmë për to.

Më e rëndësishmja prej tyre, siç thotë imam Gazaliu, është martesë, ngase paraqet mbrojtje të llojit të vet nga epshet, shumë e rëndësishme në fe, për secilin që nuk është në gjendje të mbrohet ndryshe, e ky është rasti me shumicën e njerëzve. Kur epshi e kaplon njeriun në mungesë të besimit, i cili do ta kundërshtonte (luftonte) atë, sigurisht se do ta shpjerë në shfrenim.”

Martesa pra është mbrojtje e fortë kundër sëmundjeve veneriane, të cilat janë të përhapura sot kudo në botë.

Forma e tretë e mbrojtjes është pastërtia (dëlirësia). Pastërtia kërkohet nga i martuari, por edhe nga i pamartuari, ndonëse kjo është më e nevojshme për të martuarit, prandaj dënimi për të është paraparë të jetë më i rëndë.

Për këtë shkak, ai që është në gjendje të martohet, le ta bëjë atë, sepse kështu do ta ruante gjysmën e fesë së vet, ndërsa në gjysmën tjetër le t'i frikësohet All-llahut U. Imam Hakimi transmeton fjalët e të Dërguarit ﷺ: ***“Kujt All-llahu ﷻ i dhuron grua të hajrit, i ka ndihmuar ta ruajë gjysmën e fesë së vet. Por, ai i cili nuk është në gjendje ta bëjë këtë (të martohet), le të agjërojë, sepse agjërimi për të është më i mirë.”***

Xhabiri (transmeton se i Dërguari ﷺ kishte parë një grua dhe pastaj kishte hyrë te gruaja e vet Zejnebja dhe kishte pasur marrëdhënie me të, e pastaj kishte dalur.” (Transmeton: Muslimi, Tirmidhiu dhe thotë që hadithi është hasen, sahih)

I Dërguari ﷺ thotë: ***“Kur dikush nga ju sheh ndonjë grua e cila i pëlqen atij, le të bëjë marrëdhënie me gruan e vet, sepse ajo i ka të njëjta ato që i ka ajo të cilën e ka parë.”*** (Transmeton: Muslimi dhe Tirmidhiu thotë që hadithi është hasen, sahih)

Në një transmetim qëndron: ***“Bëhuni të pastër dhe të ndersbëm, edhe gratë tuaja do të jenë të pastra dhe të ndershme. Bëhuni të mirë ndaj prindërve tuaj, edhe fëmijët tuaj do të jenë të mirë ndaj jush.”***

Ibn Abbasi, All-llahu qoftë i kënaqur prej tij, thotë: ***“Besimi i besimtarit nuk do të pranohet pa martesë (nikah)!”*** Xhunejdi thotë: “Mua më nevojitet marrëdhënia seksuale sikurse që më nevojitet ushqimi.”

Islami pastërtinë e konsideron si pyetje të rëndësishme, të cilës i kushton kujdes të veçantë. Pastërtia formohet, para së gjithash, me pastërtinë e zemrës dhe pastaj me mbrojtjen nga ndikimet e jashtme. Pastërtia e brendshme themelohet me devotshmëri, me

besim dhe me vetëdije për mbikëqyrjen e Tij mbi ne. Mandej me zbrapsjen e zemrës nga vesveset-dyshimet dhe nga epshet, të cilat qetësohen me vendosjen e tyre në vendet e duhura, përmes marrëdhënieve bashkëshortore. Ashtu siç ka vepruar i Dërguari ﷺ me bashkëshorten e vet, Zejnebe bin Xhahsh, All-llahu qoftë i kënaqur prej saj, dhe siç ka urdhëruar me fjalët: ***“Kur dikush nga ju sheh ndonjë grua që i pëlqen atij, le të bëjë marrëdhënie me bashkëshortën e vet”***, dhe siç ka vepruar Xhunejdi dhe të gjithë njerëzit e tjerë të mirë më parë dhe sot.

Sa i përket faktorëve të jashtëm, ata mund të reduktohen në ndalimin e përzierjes së meshkujve me femra, në uljen e shikimit, në shmangien e zbulimit të grave dhe të të folurit provokues (të tyre) dhe në mbylljen e dyerve të të gjitha rrugëve që shpiejnë në prostitucion, si edhe të mjeteve shfrenuese të informimit.

All-llahu ﷻ thotë: ***“Thuaju edhe besimtareve të ndalin shikimet (prej haramit), të ruajnë pjesët e turpshme të trupit të tyre, të mos i zbulojnë stolitë e tyre, përveç atyre që janë të dukshme...”*** [En-Nur: 31]

Mandej All-llahu ﷻ ka sqaruar se cilët janë ata që kanë të drejtë t'i shikojnë stolitë e gruas, pastaj ua ka ndaluar grave trokitjen me këmbët e tyre, që ashtu t'i zbulojnë stolitë që i bartin:

“...le të vënë shamitë mbi krahërorin e tyre dhe të mos ua tregojnë bukuritë e tyre askujt, përveçse burrave të vet, baballarëve të vet ose djemve të burrave të vet, djemve të vëllezërve të vet, apo djemve të motrave të veta, ose grave të tyre (që u përmendën) dhe robërshave, të cilat i kanë në pronësinë e tyre, ose shërbëtorëve nga meshkujt të cilët nuk ndiejnë nevojë për femrat, ose fëmijëve që nuk kanë arritur pjekurinë për gra. Le të mos kërcasin me këmbët e tyre për të zbuluar fshehtësinë nga stolitë e tyre.” [En-Nur: 31]

All-llahu ﷻ e urdhëron gruan të qëndrojë në shtëpinë e vet, sepse kjo është mbrojtje më e sigurtë për të. Mandej, ndalon zbulimin, çka paraqet mbrojtje për të dhe për meshkujt.

All-llahu ﷻ thotë: ***“Dhe rini në shtëpitë tua, e mos e***

shfaqni bukurinë tuaj si shfaqej në injorancën e hershme...” [El-Ahzab: 33], *“O ti i Dërguar, thuaju grave tuaja, bijave tuaja dhe grave të besimtarëve, le t’i vënë shamitë (mbulojën) e veta mbi trupin e tyre...”* [El-Ahzab: 59]

All-llahu ﷻ ua ka ndaluar grave të të Dërguarit ﷺ, kurse ne e dimë se kush ishin ato, që me të folurit e tyre të tërheqin vëmendjen në to, në mënyrë që të mos dëmtohet ai, zemra e të cilit është e sëmurë. *“O gratë e të Dërguarit, ju nuk jeni si asnjë grua tjetër, nëse keni kujdes e rubeni, andaj mos u llastoni në të folur e të lakmojë ai që ka sëmundje në zemrën e tij, po thuani fjalë të matura”* [El-Ahzab: 32]

I Dërguari ﷺ e ndaloi hyrjen te gratë, burrat e të cilave nuk janë prezentë dhe ka thënë: “Mos hyni te ato (gra) burrat e të cilave nuk janë prezentë. Me të vërtetë shejtani qarkullon në ju sikurse gjaku juaj.” (Transmeton: Tirmidhiu). *“Që sot, është e ndaluar hyrja te ato, burrat e të cilave nuk janë prezent.”* (Transmeton: Muslimi)

I Dërguari ﷺ e ndaloi vetmimin me gruan, e cila nuk është mahrem (me të cilën mund të martohet), përveçse në praninë e dikujt tjetër, që është mahrem i saj. All-llahu ﷻ e ndaloi hyrjen në shtëpitë, përveçse me leje, pas lajmërimit dhe pas selamit, në mënyrë që dikush nga ata të mos shohë diç çka nuk do të duhej të shihte.

All-llahu ﷻ thotë: *“O ju njerëz që besuat, mos hyni në shtëpitë e buaja pa kërkuar lejen dhe pa përsbëndetur njerëzit e saj. Kjo është më mirë për ju, në mënyrë që të merrni mësim.”* [En-Nur: 27]

Kuptimi i katërt i ihsanit është liria:

All-llahu ﷻ thotë: *“E kur janë të martuara ato, nëse bëjnë ndonjë punë të turpshme, ndëshkimi kundër tyre është sa gjysma e atij të grave të lira (jo robëresha).”* [En-Nisa: 25]

Dënimi për zinanë e bërë nga mashkulli apo nga femra e lirë, të cilët më parë nuk kanë qenë të martuar është 100 goditje me kamxhik, ndërsa dënimi për kundërvajtje të njëjtë i robëreshës ose i robit është dy herë më i vogël, 50 të goditura me kamxhik.

All-llahu ﷻ thotë: *“Mos i detyroni robërshat tua të bëjnë imoralitet, e për shkak të ndonjë fitimi të kësaj bote, derisa ato dëshirojnë të jenë të pastra. E kush i detyron me dhunë të bëjnë atë, All-llahu i fal ato pas atij detyrimi. All-llahu fal dhe është Mëshirues.”* [En-Nur: 33]

Ky ajet u shpall me rastin e Abdullah ibn Ubejjit, udhëheqësit të munafikëve në Medinë, i cili kishte robërsha me të cilat bënte biznes përmes prostitucionit, sikurse që edhe sot bëjnë shumë keqbërës. Tregtia me seks është veprimtari e madhe dhe e organizuar, ku punojnë me mija nëpunës dhe profesionistë, në mesin e të cilëve gjenden edhe mjekët edhe artistët, me grupe të ndryshme të mafisë dhe me tregtarë të drogës. Në Tajlandë, siç qëndron në raportin e Kombeve të Bashkuara, gjatë një jave mafia rrëmben 500 vajza, të cilat futen në rrjetin profitabil të tregtisë me seks. Pas këtyre mafive, qëndron policia, e cila u ndihmon gjatë kësaj. Në këtë shembull e shohim qartë mëshirën e Mëshiruesit, i Cili do t'i falë ata që janë të detyruar ta bëjnë këtë. Do të thotë, ato me siguri do t'i falë, por jo edhe keqbërësit e rryem që tregtojnë me trupat e tyre.

Ndonëse robërimi ka herë është abroguar, tregtia (e papastër) jo e ndershme është ende aktuale dhe në masë edhe më të madhe se më parë. Nuk ka dyshim se mëshira e All-llahut do t'i përfshijë këto të pafuqishme dhe hidhërimi dhe mllef i Tij do të zbrazet mbi kriminelët e rryem që organizuan këtë tregti të ndyer, dhe që i përhapën rrjetat e tyre me këto vajza të mitura, nganjëherë me mashtrime, e nganjëherë me dhunë. Kjo tregti është e përhapur në vendet e ndryshme të botës dhe në vendet e botës së tretë është më e fortë, më e ashpër dhe më e ndyer sesa në Evropë dhe në Amerikë.

Është e domosdoshme pra, që njeriu të çlirohet nga adhurimi i pasurisë, nga nënçmimi, nga turpi dhe nga tregtia me robër të “bardhë”, që të fiken burimet e prostitucionit.

Nga e gjithë kjo, pamë se “ihsani” - “pastërtia,” me të gjitha kuptimet e veta, është zgjidhje më e drejtë për shërimin e sëmundjeve veneriane dhe për ndalimin e zinasë dhe të të gjitha

formave të seksit të shfrenuar.

Në “ihsanin” e suksesshëm merr pjesë edhe ndalesa e çdo gjëje që shpie në prostitucion dhe në shfrenim. Ndalimi i medimeve të ndryshme, i arteve dhe i dëfrimeve që thërrasin në shfrenim të fshehur apo të hapur. Po ashtu, “ihsani” i suksesshëm nënkupton ndalimin e të gjitha llojeve të shfrenimit, sikurse që janë baret e natës, teatrot, kabaretë, përzierja e njerëzve me gra të zbuluara e gjysmëlakuriqe dhe ndalimin e gjithë asaj që ndodh në bazene dhe në plazhe, në shumë vende islame, arabe dhe joarabe, çka është e turpshme dhe tronditëse.

“Ihsani” i suksesshëm, nënkupton zbatimin e dënimeve të cilat All-llahu ﷻ i ka caktuar për ata që bëjnë prostitucion, sepse këto dënime janë pengesë e madhe për kryerjen e veprave të tilla të këqija. Ngase All-llahu ﷻ me pushtet ndalon shumë gjëra çka nuk ndalon me Kur’an.

Në “ihsanin” e suksesshëm merr pjesë edhe abrogimi i të gjitha ligjeve njerëzore që janë në kundërshtim me urdhrat e All-llahut ﷻ dhe që lejojnë prostitucionin, kamatën dhe alkoolin. Shumica e atyre ligjeve (njerëzore) e ndalojnë martesën me më tepër se me një grua, kurse e lejojnë ”shoqërimin” e një njeriu me dhjetëra gra.

Ligje të shumta të lidhura për familje dhe për të drejtën e familjes, paraqesin pengesë në rrugë të martesës, kurse në të njëjtën kohë ligjet e tjera e lehtësojnë prostitucionin, me të gjitha llojet dhe format e saj.

Prandaj është e pamundur të formohet një shoqëri e shëndoshë dhe e pastër para abrogimit të këtyre ligjeve njerëzore dhe para vendosjes së ligjeve të shariatit dhe zbatimit të tyre. Kjo është zgjidhje e vërtetë, përveç së cilës nuk ekziston tjetër. Prandaj kthehujuni All-llahut, e Ai pranon ata që tek Ai kërkojnë strehim dhe tek Ai do të kthehemi të gjithë, ndërsa All-llahu udhëzon në rrugë të drejtë atë të cilin Ai dëshiron.

Zgjidhja e problemit të sëmundjeve gjenitale përbëhet në mënjanimin e shkaqeve të tyre:

1. Ndalimi i prostitucionit të hapur apo të fshehur, përmes mënjanimin të shkaqeve dhe të shkaktarëve të tij. Mandej, lehtësimi

i vendosjes së martesës dhe shkatërrimi i grupeve tregtare me trupin e njeriut, si edhe zbatimi i dispozitave të sheriatit për ata që bëjnë zina, për homoseksualët dhe për çdo formë të seksit të shfrenuar;

2. Abrogimi i vendeve për “argëtim”, i bareve, i vendeve “turistike” në vendet islame;

3. Lufta kundër alkoolit dhe kundër drogës dhe ndalimi i shitjes së tyre, i shpërndarjes, i prodhimit dhe zbatimi i ligjeve të sheriatit lidhur me to;

4. Ndalimi i shkollimit të përbashkët (të meshkujve dhe të femrave);

5. Prodhimi i programeve drejtuese, që do të plasohen përmes mas-mediumeve, lufta kundër mjeteve shfrenuese të informimit dhe dënimi i të gjithë atyre që dëshirojnë të përhapin prostitucionin në mesin e besimtarëve;

6. Ndalimi i turizmit, veçanërisht nga vendet e pasura me naftë, në Evropë, në Azinë Lindore dhe në vende të tjera të botës. Ndalimi i udhëtimit për të rinjtë, pa familjet e tyre;

7. Përhapja e vetëdijës fetare dhe shëndetësore dhe ngritja e imanit;

8. Studimi i shfaqjes së shpërnguljes nga fshati në qytet, veçanërisht për shkak se shumica e tyre i braktis familjet e veta në fshat;

9. Studimi i problemit të udhëtimit të punëtorëve dhe të nëpunësve jashtë atdheut të tyre, duke lënë familjet e veta dhe largimi i tyre nga gratë e tyre për një kohë të gjatë;

10. Studimi i problemit të punësimit të gruas dhe i përzierjes së saj me meshkuj në zyre dhe në fabrika, dhe ndalimi i kësaj. Kthimi i gruas muslimane në shtëpinë e saj, ku fusha e veprimtarisë dhe kontributi është i hapur dhe i gjerë.

Ekzistojnë edhe disa masa kujdesi të cilat i ka përcaktuar islami dhe të cilat gjithashtu i mbrojnë bashkëshortët që t’ia bartin sëmundjen njëri-tjetrit me kontakte intime (marrëdhënie seksuale, e të tjera).

Këto rregulla mund të reduktohen në këto pika:

1. Larja e organit gjenital pas nevojës dhe pas kryerjes së marrëdhënieve seksuale;

2. Larja pas marrëdhënieve seksuale dhe pas polucionit;

3. Synetimi. Është konstatuar se synetimi e zvogëlon mundësinë e sëmurjes nga sëmundjet e ndryshme seksuale;
4. Mënjanimi i qimeve nga vendet e turpshme, çka e pengon përhapjen e sëmundjeve seksuale, e veçanërisht morrat dhe zgjeben;
5. Largimi i qimeve nën sqetull, çka po ashtu pengon bartjen e sëmundjeve të caktuara përmes kontakteve intime, sikurse që janë morrat dhe zgjebja;
6. Prerja e thonjëve dhe larja e pjesëve mes gishtërinjëve;
7. Larja e dhëmbëve. Është konstatuar se larja e dhëmbëve zvogëlon mundësitë e bartjes së sëmurjes përmes buzëve dhe pështymës.

I Dërguari 龔 ka thënë: *“Cilësitë e lindura janë pesë ose pesë gjëra janë fitre (cilësi të lindura): synetimi, mënjanimi i qimeve nga vendet e turpshme, shkurtimi i thonjve, ndukja e qimeve nën sqetulla dhe shkurtimi i mustaqeve.”* (Transmeton: Buhariu, Muslimi, Nesaiu dhe Tirmidhiu)

Në hadithin tjetër qëndron: *“Dhjetë gjëra janë cilësi të lindura (fitra): shkurtimi i mustaqeve, lëshuarja e mjekrës, përdorimi i misvakut, pastrimi i hundës me ujë, shkurtimi i thonjve, larja e këmbëve mes gishtërinjëve, largimi i qimeve nën sqetull, largimi i qimeve nga pjesët e turpshme, pastrimi me ujë pas nevojës.”* Transmetusi thotë: “Të dhjetën gjë e kam harruar, por mendoj që është shpërlarja e gojës.” (Transmeton: Muslimi, Ebu-Davudi dhe Tirmidhiu)

Prerja e mustaqeve do të thotë shkurtimi i tyre. Lëshuarja e mjekrës është mbajtja e saj derisa të bëhet shumë e gjatë.

Disa dijetarë mendojnë se mjekrën duhet lënë të rritet derisa ta arrijë gjatësinë e shuplakës. Kurse larja e dhëmbëve bëhet me misvak ose me diç tjetër.

I Dërguari 龔 ka caktuar periudhën, gjatë së cilës duhet të mënjanohen qimet nga nënsqetullat dhe nga vendet e trupshme, në katërdhjetë ditë. Do të thotë që periudha më e gjatë në të cilën ato vende mund t'i lëmë pa i pastruar është dyzet ditë. Ndërsa sunnet

është që ato vende të pastrohen dhe thonjtë të priten çdo të premtë.

Prostitucioni (zinaja) - Nocioni

“Zina”, si shprehje sheriatike, nënkupton marrëdhëniet seksuale të një mashkulli përgjegjës para ligjit (të rriturit, të vetëdijshmit) me një grua të tillë po ashtu, në mënyrë joligjore. Shprehja e këtillë është e njohur në terminologjinë e jurisprudencës sonë qytetare nën emrin (prostitucion), por ky ka domethënie shumë më të ngushtë nga shprehja “zina”; është marrëdhënie e paligjshme seksuale, edhe nëse ndodh vetëm një herë në jetë nga cildo shkak dhe epsh. Prostitucioni i këtillë në islam është rreptësisht i ndaluar dhe numërohet në mëkate të mëdha.

Argumentet e ndalesës

Ndalimi i prostitucionit bazohet në Kur'an dhe në Sunnet. Kur'ani flet për këtë vepër të shëmtuar në disa vende, e sidomos bien në sy këto ajete:

1. *“Dhe mos iu afroni imoralitetit (zinasë), sepse vërtet ai është vepër e shëmtuar dhe është një rrugë shumë e keqe.”* [El-Isra: 32]
2. *“Edhe ata që pos All-llahut, nuk lusin ndonjë Zot tjetër dhe nuk mbysin njeriun që e ka ndaluar All-llahu, por vetëm kur e meriton në bazë të drejtësisë, dhe që nuk bëjnë kurvëri, ndërsa kush i punon këto ai e gjen ndëshkimin.”* [El-Furkan: 68]
3. *“...dhe ata që e ruajnë nderin e vet (sa i përket jetës intime).”* [El-Mu'minunë: 5], *“Edhe ata që janë ruajtur prej punëve të ndyra (amoralë).”* [El-Mearixh: 29]

Prej haditheve që flasin për prostitucionin, sidomos duhet theksuar këtë:

1. *“Ai që bën zina, nuk mund të jetë besimtar i vërtetë derisa e*

bën atë.” Këtë hadith e transmetojnë Buhariu, Muslimi dhe të tjerët, nga Ebu Hurejre.

2. “Kur njeriu bën zina, nga ai del imani dhe mbi kokën e tij qëndron si freski. Nëse pastaj pendohet dhe i shmanget kësaj, imani përsëri i kthehet.”

Rreptësia e ndalesës, madhësia e mëkatit dhe tmerret e pasojës së prostitucionit, shkurtimisht, por shumë qartë janë cekur në të gjitha citatat e sipërthëna, e veçanërisht në ajetin e parë. I Lartësuar, siç shihet nga ky ajet, ndalon edhe të bëhet ajo që do të mund të na afronte në zina, përkatësisht që madje tërthorazi do të mund të shkaktonte që të vijë deri tek ajo. Në ndalesë të këtillë pasqyrohet urtësia dhe dituria e Krijuesit të Mëshirshëm. Përveç kësaj, Ai shumë mirë i njeh edhe anët tona të dobëta; Ai shumë mirë e njeh epshin dhe rëndësinë e tij në jetën dhe në veprën e secilit njeri. Epshi seksual te njeriu është ajo me të cilën ai më së tepërmi i afrohet kafshës, nga e cila ndonjëherë nuk e ndan asgjë. Sepse gjatë shfaqjes së këtij epshi te pakkush dominon arsyeja dhe njeriu nuk mund të rezistojë, e duhet ta kënaqë atë pa marrë parasysh çmimin, madje ai do të bënte mëkat, nëse do ta kënaqte në kundërshti me ligjet e All-llahut. Epshi seksual, siç është e ditur, te secili mashkull dhe femër normale fillon dhe mbaron pas një kohe të caktuar. Ai shfaqet vetvetiu, për krijimin e tij nuk është i nevojshëm ndonjë faktor i jashtëm; ai është kryesori në ruajtjen e gjinisë njerëzore (siç vlen në përgjithësi edhe për kafshët). Njeriu i cili kryen marrëdhënie seksuale, është i bindur fortë se kështu ai është duke e kënaqur veten e tij, por nuk mendon se ai gjatë kësaj është lodër në duart e një fuqie më të lartë; ai gjithashtu nuk e di se kjo kënaqësi nuk i shërben atij, por ruajtjes së llojit njerëzor. Faktorët e jashtëm, të cilët i përmendëm, në këtë pikëpamje luajnë rol shumë të rëndësishëm. Ata mund ta shpejtojnë krijimin e shtytjes seksuale të njeriut dhe çka është edhe më e keqja, ata e forcojnë aq shumë, sa që njeriu mund ta humbasë vetëkontrollin plotësisht. E kur vjen deri te kjo, e kjo ndodh rregullisht, atëherë kjo shtytje e bën të veten. Pra për ta pamundësuar kënaqjen e shtytjes së vet seksuale në mënyrë jologjore, njeriu duhet t'i

shmanget çdo gjëje që do të mund të nxiste këtë shtytje, madje nëse kjo në shikim të parë do të dukej tërësisht e pafajshme. Duhet ta dijë se fundja ai është njeri, por edhe përkundër këtij fakti ai lëshohet në sprova, kur vetes ia lejon këtë provokim, atëherë është shumë vështirë, të mos themi e pamundur, se ai do të mund të përmbahet nga kryerja e zinasë, sado që të jetë i dhënë pas islamit. Duke i marrë parasysh rrethanat e pastra psikologjike të secilit njeri, në këtë pikëpamje, i Lartësuar i në ajetin e parë të lartëpërmendur nuk ka thënë: “Mos bëni zina”, por, “Mos iu afroni imoralitetit (zinasë)..” [El-Isra: 32] Paraveprimet pra, janë ajo që mund dhe që ka kuptim të ndalohen.

Mes shumë faktorëve që ndikojnë në lakmitë seksuale, që doemos sjellin deri te vetë akti i prostitucionit, gjithsesi është kontakti i shpeshtë i mashkullit me femrën, të cilët janë të huaj për njëritjetrin, mandej lakuriqësia e femrave dhe të tjera. Disa të prishur, që në pengimin e kësaj e shohin pengimin e planeve të veta më të errëta, pohojnë se kjo për njeriun modern nuk do të thotë asgjë dhe se kjo nuk është kurrfarë faktori që do të mund të nxiste epshin, andaj edhe përpjekja për të ardhur gjer te kjo është shenjë e prapambeturisë dhe e errësirës. Duke u përgjigjur në këtë, nuk është e nevojshme të tregojmë për indiferentizmin fetar dhe për shpërfilljen e kujdesit për nderin, për dinjitetin e të gjithë njerëzve, veçanërisht të grave, por për të gjitha këto mund të themi vetëm këtë: të gjithë këta faktorë mund të bëhen të parrezikshëm për njeriun, vetëm atëherë kur njerëzit do të jetojnë pa epshe seksuale!

Arsyetimi i ndalesës

Duke e arsyetuar ndalesën e Vet për t'iu afruar prostitucionit, i Lartësuari më tutje në ajetin e njëjtë thotë se prostitucioni është vepër më se e shëmtuar, dhe se rruga kah prostitucioni është rrugë e keqe. Prostitucioni është një e keqe, pasojat e të cilit nuk mund të parashikohen. Në kohën kur kjo e keqe u ndalua, këto pasoja nuk kanë qenë as prej së largu aq të numërta, as aq fatale, sa janë sot, madje shumica nuk kishin fare njohuri për këtë. Megjithatë, ndalesa e kësaj të keqe, atëherë ka ndikuar aq shumë, sa që rastet e prostitucionit kanë qenë krejtësisht të rralla, sepse ata plotësisht ishin bindur në vërtetësinë e fjalëve të Kur'anit për çdo gjë, e edhe për prostitucionin. Sot, kur pasojat e tij janë të shumta, dhe kur bota konsiderohet humane, nuk ndërmerret gati asgjë me qëllim të shkatërrimit të kësaj veprë të shëmtuar. Kjo e keqe po bën kërdi tani nëpër botë, ajo po fut përçarje në familje të shumta, duke e fikur nderin, shëndetin, madje edhe jetën e shumë femrave; përmes prostitucionit përhapen sëmundjet infektive dhe të pashërueshme; për shkak të kësaj shfaqet një problem shumë i madh dhe brengosës shoqëror, por, megjithatë, të gjitha këto në tërë botën durohen? Dhe çka është më pikëlluese, prostitucioni është shumë i përfaqësuar në mesin e muslimanëve dhe asnjë shoqëri e sotme islame nuk ndërmerr gati asgjë për t'i japur fund kësaj. Bile sot, secili e ka të qartë se çfarë do të thotë prostitucioni nga aspekti mjekësor, human, etik, shëndetësor dhe nga cilido aspekt tjetër, dhe se çfarë të këqija ai i shkakton individit dhe shoqërisë, por megjithatë durohet për hirë të “dashurisë”? E muslimanët? Ata kaherë kanë shfaqur dëshirë për t'iu shmangur dispozitave të All-llahut, qofshin ato në formë të urdhërave apo të ndalesave. Kjo dëshirë është pasojë natyrore e pasimit të verbër të asaj çka vetëm të prishurit mund ta quajnë civilizim dhe të çdo gjëje negative që ky

“civilizim” bart në vete. Ndërkaq, pasojat e kësaj më së miri pasqyrohen në gjendjen e tyre të mjerueshme morale, fetare dhe shoqërore. Duke i vështruar të gjitha këto, njeriut të arsyeshëm, mund vetëm t’i vijë keq, pse është në këtë pikëpamje “I civilizuar”, madje edhe nëse do ta quanin “të prapambetur” dhe “obskurantist”!

Dënimi

All-llahu ﷻ jo vetëm që e ndaloj zinanë, por për këtë vepër urdhëroi edhe dënimin. Sipas peshës së këtij mëkati është urdhëruar edhe dënimi i rëndë. Ky dënim nuk është i njëjtë për të gjithë individët. Me fjalë të tjera, në shqiptimin e dënimit duhet të kihet kujdes nëse i akuzuari është i martuar apo jo. Nëse ky është rasti i parë, atëherë vendoset dënimi me gurëzim, derisa në rastin tjetër i pandehuri dënohet me rrahje publike, me njëqind të goditura me shkop. Edhe njëri, edhe tjetri dënim janë nënçmim i rëndë, e këtë Gjykuesi e ka urdhëruar që ato të kenë ndikim të madh edhe te të tjerët. Ky dallim në peshën e dënimit, justifikohet me faktin se e martuara ose personi i martuar di t'i çmojë vlerat dhe shenjtërinë e martesës më mirë se i pamartuari, përkatësisht e pamartuara, dhe si rrjedhim i kësaj është i vetëdijshëm për peshën e mëkatit dhe të turpit që ia shkakton personit të çnderuar dhe familjes së saj.

Shqiptimi dhe zbatimi i këtyre dënimeve është i kushtëzuar me pranimin e katërfishtë të të pandehurit se e ka bërë atë mëkat. Vërtet, dënimi i këtillë mund të shqiptohet dhe në bazë të dëshmisë së përbashkët të katër dëshmitarëve (vetëm meshkuj), të cilët janë të obliguar të argumentojnë se i kanë parë mëkatarët në vepër. E kjo është aq e vështirë, sa që kufizohet me të pamundurën. Nëse i vështrojmë hadithet që flasin për këto dënime, që janë shqiptuar dhe janë ekzekutuar në kohën e të Dërguarit të All-llahut dhe të halifeve të parë, do të shohim se ato janë shqiptuar vetëm në bazë të pranimit katër herë të mëkatarit. Por edhe atëherë kur mëkatarin vinte dhe pranonte veprën e vet, bëheshin përpjekje për t'i sugjeruar atij se ndoshta ai vetëm e ka prekur gruan, në mënyrë që ai të heqë dorë nga pranimi i vet dhe që të mos vijë deri te ekzekutimi i dënimit me vdekje - gurëzimi. Vetëm atëherë kur personi përkatës në pranimin e vet mbetej këmbëngulës, vinte deri

te dënimi i tillë me vdekje. Ndërsa, raste të këtilla ka pasur fare pak. Sepse që dikush ta pranonte mëkatën e vet të tillë, duke e ditur se çfarë dënimi i rëndë dhe nënçmues e pret, duhej të ishte i përfshirë thellësisht me ndjenja fetare, me dëshirë që në këtë botë të dënohet për kundërvajtje të bërë dhe duhej të ishte plotësisht i sigurtë në faljen e mëkatit të vet pas dënimit të zbatuar.

Kemi përmendur se dënimi me vdekje mund të shqiptohet në bazë të dëshmisë së përbashkët të katër dëshmitarëve meshkuj. Sikur vetëm njëri ta tërhiqte dëshminë pasi ta ketë deklaruar atë, do të dënoheshin të gjithë me nga 80 goditje, ndërsa dëshmia e tyre në të ardhmen nuk do të pranohej. Këto masa të rrepta të mbledhjes së dëshmive për bërje të zinasë kanë rëndësinë e vet të madhe, ngase në këtë mënyrë përjashtohet mundësia jo vetëm e shpifjes, por edhe e dyshimit se dikush ka bërë diç të tillë. Për këtë flet Kur'ani në suren [En-Nur: 4] ku thuhet:

“Edhe ata që bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, rribni me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos u pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm.”

“LIAN”

Ngjan që burri ta akuzojë gruan e vet për zina. Në këtë rast, pohimin e vet burri nuk është i detyruar ta mbështesë me dëshminë e katër dëshmitarve, ngase kjo gjë (akuzimi i gruas) është shumë e rëndë për të, gati pothuajse e pamundshme. Përveç kësaj, burri nuk ka kurrfarë interesi që gruan ta shndërrojë në dashnore, siç do të mund ta kishte një person i huaj, dhe kur pra ai e ngarkon gruan e vet, supozohet që pohimi i tillë i tij është i bazuar mbi të vërtetën. Megjithatë, as pohimi i tij nuk mund të pranohet pa vërtetime të mëtijshme, por gjyqtari i sheriatit, para të cilit e ka parashtruar këtë padi, do ta udhëzojë që ai këtë ta fuqizojë me katër deklarime të veta të njëpasnjëshme. Në të vërtetë, burri me këtë rast do të thotë se betohet në All-llahun, se është duke e thënë të vërtetën, kurse të pestën herë do ta thërrasë mbi vete mallkimin e All-llahut nëse gënjen. Nëse gruaja pas kësaj dëshmie pranon se ka bërë dashuri, do të dënohet, e nëse nuk pranon, atëherë edhe ajo është e detyruar të deklarojë katër herë, do të betohet katër herë në All-llahun se burri i saj ka gënjyer, e herën e pestë do ta thërrasë hidhërimin e All-llahut mbi vete, nëse është e vërtetë ajo çfarë ka thënë burri i saj. Në këtë rast, gruaja nuk do të dënohet, por martesë e tyre përgjithmonë do të prishet. Procesi i këtillë në të drejtën islame quhet “lian” (mallkimi i ndërsjellë i burrit dhe i gruas) dhe është urdhëruar me ajet Kur’anor, kuptimi i të cilit është paraqitur më lartë.

Përfundim

Nga e tërë kjo, mund të sjellim këtë përfundim:

1. Krimi seksual është mëkat shumë i rëndë, me pasoja të shumta dhe të rënda, jo vetëm për individin, por edhe për tërë shoqërinë, si edhe për pasardhësit. Për t'iu shmangur kësaj, duhet larguar nga të gjitha veprimet që shpiejnë tek ai (krim), e që në shikim të parë duken tërësisht të padjallëzuara , prandaj shoqëria është e obliguar të marrë masa në këtë drejtim.
2. Sipas peshës së këtij mëkati, është urdhëruar edhe dënimi i rëndë, me të cilin dëshirohet të frikësohen njerëzit e tjerë, por i cili është i njëjtë si për femra, ashtu edhe për meshkuj;
3. Se vërtet qëllimi i dënimit të përmendur është largimi nga e keqja, shihet qartë nga ajo se e drejta e shariatit për argumentimin e këtij krimi ka paraqitur kushte shumë të rënda dhe gati të paretizueshme. Nëse krimi argumentohet me katër dëshmitarë që e kanë parë qartë aktin, pa kurrfarë dyshimi dhe pastaj për këtë caktohet dënimi shumë i rëndë, kjo do të thotë se dëshirohet shmangia e zbatimit të këtij dënimi, por nëse krimi vërtetohet në këtë mënyrë, atëherë ky është një skandal publik pa fije turpi, rrënjët e të cilit duhet prerë. Këtë duhet pasur parasysh, kur të mendohet për dënimin të cilin e drejta e shariatit e parasheh për këtë lloj të krimit.

Përmbytja:
